

MIROSLAV BOSHKOVIQ

DANÇE MAÇEVSKA

HISTORIA E MAQEDONISË

PËR
VITIN II

arsimi i mesëm profesional

KOMISIONI RECENSUES

Prof. D-r Margarita Peshevska
Prof. Sashko Korçovski
Prof. Sllavço Markovski

Përkthyes: Vjosa Taipi

Redaktor profesional: Prof. D-r Asllan Hamiti

Lektor: Mr. Ismail Hamiti

Botuesi: Ministria e arsimit dhe shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtypi: Graficki centar dooel, Shkup

Tirazhi: 2.000

Me vendim të Ministrisë për arsim dhe shkencë ë Republikës së Maqedonisë Nr. 22-4680/1 prej datës 27.08.2010 lejohet përdorimi i këtij teksti shkollor.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент Охридски”, Скопје
94 (497 . 7) (075.3)
930 . 85 (497 . 7) (075.3)

БОШКОВИЌ, Мирослав
Историја на Македонија за II година средно стручно образование / Мирослав Бошковиќ,
Данче Мачоска. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република
Македонија, 2010, - 147 стр. : илустр. ; 30 см

ISBN 978-608-226-190-4
COBISS.MK-ID 84323850

PARATHËNIE

Teksti shkollor Historia e Maqedonisë për vitin e dytë, arsimit të mesëm profesional është hartuar sipas FLRE - programi arsimor për të gjitha drejtimet e mësimin të mesëm profesional në Republikën e Maqedonisë, të cilat këtë lëndë e mësojnë me fond prej dy orësh në javë, përkatësisht 72 orë në vit. Materiali mësimor përfshin 40 njësi mësimore, të sistemuara në pesë tërësi tematike: Maqedonia gjatë kohës antike, Maqedonia në mesjetë, Maqedonia nën pushtimin otoman (deri në mesin e shek. XX, Lufta nacionalçlirimtare e popullit maqedonas deri në Luftërat Ballkanike dhe Maqedonia nga Luftërat Ballkanike deri në pavarësinë e saj.

Me përmbajtjet e dhëna mësimore nxënësit kanë mundësi të njoftohen me ngjarjet më të rëndësishme historike, proceset, personat dhe arritjet kulturore për Historinë e Maqedonisë, duke filluar nga periudha parahistorike, e deri në historinë bashkëkohore, përkatësisht krijimin e Republikës së Maqedonisë të pavarur dhe sovranë.

Gjatë shtjellimit të përmbajtjeve mësimore në veçanti kemi mbajtur llogari që t'i sqarojmë lidhjet ndërmjet shkaqeve dhe pasojave të dukurive, ngjarjeve, proceseve dhe veprimtarisë së personave të caktuar. Vazhdimisht mbajtem llogari përmbajtjet mësimore të mos jenë shumë të gjata dhe të ngarkuara me shumë të dhëna faktografike, ndërkaq në tekst të inkorporohen arritjet moderne të shkencës së historisë, duke i kënaqur kërkesat shkencore, edukative dhe metodologjike - didaktike të mësimin të lëndës së historisë.

Përmbajtjet mësimore në mënyrë të pasur janë ilustruar me fotografi të ndryshme, harta, vizatime, skica etj, të cilat ofrojnë pasqyrë vizuale për ngjarjet dhe tërësitë tematike të mësuara. Rekomandohet arsimtarët e historisë për njësitë mësimore, për të cilat janë ruajtur përmendore kulturore - historike dhe përmendore tjera, të realizojnë mësim në terren.

Urojmë tekstin shkollor t'u përgjigjet qëllimeve dhe detyrave të parapara me programin mësimor, ndërkaq të gjitha mangësitë e identifikuar nga aspekti profesional dhe metodologjik - didaktik me kënaqësi do të pranojmë t'i inkorporojmë në botimin e ri.

Autorët

TEMA 1.
MAQEDONIA NË PERIUDHËN ANTIKE

MAQEDONIA NË KOHËN PARAHISTORIKE

Territori i Maqedonisë sipas pozitës gjeografike ndodhet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik dhe paraqet një nga udhëkryqet kryesore për lidhjet ekonomike dhe kulturore ndërmjet Evropës Jugore dhe asaj të Mesme. Nëpër të, që nga e kaluara më e largët janë ndërthurur traditat e popujve dhe grupacioneve të ndryshme etnike të cilat janë ndërruar brenda epokave historike, duke lënë gjurmë të pasura dhe të dukshme të ekzistencës së tyre, sot të dëshmuara nëpërmjet gjetjeve të shumta arkeologjike. E gjithë kjo ka kontribuar që kultura në Maqedoni të ketë zhvillimin e saj specifik.

MAQEDONIA NË KOHËN E NEOLITIT

Gërmimet e deritanishme arkeologjike kanë dëshmuar se gjurmët më të vjetra të jetës së njerëzve në Maqedoni, buron që nga koha e periudhës së neolitit (koha e re e gurit), nga koha kur veç më ka ekzistuar bujqësia primitive dhe janë paraqitur fillimet e blegtorisë.

Dega themelore ekonomike me të cilën është marrë popullsia në Maqedoni gjatë kohës së neolitit ka qenë bujqësia. Në përfundim të këtillë na udhëzojnë një numër i madh i bujqësore të drithërave të mbetura. Nga mjetet e punës gjatë neolitit në Maqedoni janë zbuluar gurë të lëmuar (të përpunuar) sëpata, në formë të shtypur ose trapezoide. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe në Maqedoni njerëzit e kanë njohur, përpunuar dhe përdorur qeramikën, prej të cilës përpos enëve për përdorim të përditshëm është përpunuar edhe qeramikë e gdhendur (idhuj perëndish dhe figura të tjera njerëzore). Nga koha e neolitit është gjetur edhe armë, siç është hobeja, prej së cilës kanë hedhur topa në formë veze.

Njerëzit në këtë periudhë kanë jetuar në shtëpi prej balte, ndërsa përreth lumenjve dhe liqeneve në vendbanimet mbi hunj.



Trebenishte - Maska e florinjtë

TEMA 1

Gjetjet arkeologjike të kohës së neolitit në Maqedoni janë zbuluar në: Porodin (Manastir), Vranishtë (Strugë), Vërshnik, Tarinci (Shtip), Maxhari (Shkup) etj.

Pse Maqedonia ka qenë e banuar qysh në kohën më të vjetër?

MAQEDONIA NË KOHËN E BRONZIT

Në territorin e Maqedonisë ka gjetje të shumta nga koha e bakrit, bronzit dhe hekurit. Epoka e bronzit ka zgjatur deri në shekujt e fundit të mileniumit të tretë deri në vitin 1200 p.e.s. Një prej karakteristikave të vendbanimeve të epokës së bronzit në Maqedonisë, është se ato janë ndërtuar në vende të larta dhe vështirë të arritshme, siç ka qenë rasti me Kalanë e Shkupit dhe Shuplevacin. Kjo çon drejt konkludimit se në Epokën e bronzit në hapësirat e Maqedonisë ka pasur trazira dhe kohëra të bujshme të përcjella me shpërngulje (dyndje) të fiseve të ndryshme dhe për shkak të sigurisë më të madhe të njerëzve, vendbanimet e tyre i kanë ndërtuar në vende vështirë të arritshme. Nga kjo periudhë janë gjetur edhe lëndë të qeramikës cilësore, ndërkaq ka qenë e zhvilluar edhe gurgdhendja. Janë përpunuar lëndë të ndryshme, ndër të cilat më karakteristike janë figurat e njerëzve në pozitën ulur.

Gjetje të cilat datojnë nga kjo periudhë ka në Kalanë e Shkupit, pastaj në luginën e Pellagonisë (në vendet e quajtura Cërnobuki, Bareshan dhe Kravari), Demir Kapi, ndërkaq gjetje më të rëndësishme të kësaj periudhe paraqet lokaliteti Armenahari në pjesën e Maqedonisë së Egjeut.

Kah fundi i epokës së bronzit dhe fillimi i epokës së hekurit, rreth vitit 1300 - 1200 para erës sonë, territori i Maqedonisë ishte përfshirë nga sulme dhe nga e ashtu quajtura shpërngulje e Egjeut, e cila ka zgjatur disa shekuj. Kjo ka qenë kohë e shkatërrimit të kulturës së vjetër mikene.

Cilat janë karakteristikat e vendbanimeve të epokës së bronzit në Maqedoni?



Trebenishte - Maska e florinjtë

MAQEDONIA NË EPOKËN E HEKURIT



*Mbretëresha e madhe - nënë nga
Makhari, Shkup*

Pind, ndërkaq në veri deri te lugina e Shkupit - Kumanovës. Me forcimin e aristokracisë fisnore, në Maqedoni janë krijuar më shumë shtete, të cilat mes vete shpesh kanë luftuar për mbisundim.

Epoka e hekurit në Maqedoni fillon prej vitit 1300 p.e.s. dhe zgjat deri në shek. IV p.e.s. Lokalitete më të njohura arkeologjike të kësaj periudhe janë në: Demir Kapi, Varosh në Prilep, Manastir, Ohër, në Maqedoninë Lindore (Radanje, Orlovi Çuki, Orizari), Vollkovë, Brazda (Shkup) etj.

Rreth 700 vjet p.e.s. kur kanë ekzistuar lidhje tregtare të fuqishme në bregdetin helen, në përpunimin e sendeve të kësaj periudhe ndjehen ndikime të caktuara helene. Nga kjo periudhë veçanërisht të rëndësishme janë zbulimet në Trebenishtë, Ohër si p.sh., maskat e arit, sandale etj.

Territorin e Maqedonisë atëherë e kanë banuar fise të ndryshme, ndër të cilat më të njohura kanë qenë Pajonët, Pellagonët, Brigët dhe Maqedonasit të cilët e kanë banuar pjesën më të madhe të Maqedonisë, në jug deri te mali



Helmetë hekuri

Thuaji fiset më të njohura të cilat e kanë banuar Maqedoninë gjatë epokës së hekurit? Hulumto, zbulo! A janë zbuluar deri më tani në hapësirën e Maqedonisë lokalitete të epokës së paleolitit?

KRIJIMI DHE ZHVILLIMI I SHTETIT MAQEDONAS

TERRITORI, KUSHTET NATYRORE DHE POPULLSIA

Maqedonia Antike ndodhej në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, prej lumit Mesta në lindje deri te mali Pind, Galiçicë dhe Jabllanicë në perëndim, prej Olimp të jugut deri në malin Jakupica, lumin Pčinja, malin e Osogovës në veri. Autorët antikë duke pasur parasysh pozitën gjeografike, reliefin dhe konfiguracionin, territorin e saj e kanë ndarë në Maqedoni të Sipërme dhe të Poshtme. Territori i saj ka qenë i pasur me kullosa të bujshme dhe lugina pjellore. Territori i Maqedonisë së sotme gjeografike në të kaluarën e largët ka qenë e populluar me fise dhe popuj ndër të cilët më të njohur janë: Edonët, Pellazgët, Brigët, Maqedonasit antikë, Pelagonezët, Trakët, Helenët, Orestët etj. Këto fise dhe popuj gradualisht janë përzier ndërmjet vete dhe kanë formuar një popull me gjuhë të përbashkët, e quajtur maqedonase sipas emrit të tokës të cilët e kanë populluar. Kështu janë krijuar Maqedonasit antikë, të cilët kanë paraqitur etnos të veçantë me traditë të veçantë dhe kulturë dhe janë dalluar nga popujt tjerë të Gadishullit Ballkanik.

Në kohën më të vjetër në Maqedoni është ruajtur mënyra e jetës në fise. Popullata kryesisht është marrë me bujqësi, blegtori dhe peshkim. Ka disponuar me pyje të pasura me kafshë të egra dhe kullosa, si dhe me pasuri të xeheroreve.

FORMIMI I SHTETIT MAQEDONAS

Sipas traditës antike themelimi i shtetit maqedonas i atribuohet mbretit Perdika I (707-659 p.e.s.), i cili ka formuar dinastinë e Ergeadëve. Kryeqyteti i saj ndodhej në qytetin Ejga. Një prej trashëgimtarëve të Erhelait ka transferuar kryeqytetin nga Ejga në Pella.

Në rregullimin politik të Maqedonisë së vjetër një kohë të gjatë janë ruajtur pjesët e mbetura të demokracisë luftarake. Me shtetin kanë qeverisur mbretër, pushteti i të cilëve ka qenë i kufizuar nga ana e Këshillit të heterëve (miqtë e mbretit), në të cilin kanë bërë pjesë përfaqësues të aristokracisë ushtarake - bujqësore. Ka ekzistuar edhe Kuvendi popullor, i cili në fakt ka qenë kuvend luftarak. Kah fundi i shek. IV p.e.s., Maqedonia e vjetër ka vendosur lidhje tregtare dhe ekonomike me shtetet greke, që ka kontribuar që të zhvillohet zejtaria dhe tregtia. Kah fundi i shek VI. p.e.s. mbreti Eminta I (541 - 498) është dashur një kohë të caktuar të pranojë pushtetin e Persisë. Pas betejës në Platejë në vitin 479 p.e.s. Maqedonia është liruar nga pushteti persian.

Cilat rajone kanë bërë pjesë në Maqedoninë antike?



Pella

FORCIMI I SHTETIT MAQEDONAS GJATË KOHËS SË FILIPIT II


Shteti maqedonas ka arritur progres dhe forcim të shpejtë gjatë kohës së mbretit Filipi II (359-336 p.e.s.). Ai ka qenë qeverisës i arsimuar dhe i aftë.

Filipi II ka tentuar të shfrytëzojë dobësinë e shteteve helene dhe të qeverisë me gjithë Heladën, dhe me shtetet tjera fqinje. Për këtë arsye e ristrukturoi ushtrinë maqedonase, dhe krijoi këmbësori të shkëlqyer të quajtur fallanga maqedonase. Fallanga maqedonase përbëhej prej 16 reshta ushtarësh të armatosur me heshta të gjata dhe mburoja. Pjesët anësore të falangës janë mbrojtur prej kalorësisë dhe këmbëorisë lehtë të armatosur. Përpos kësaj Filipi II ka zbatuar reforma edhe në rregullimin e brendshëm të shtetit maqedonas. Kështu, në sferën e financave



Filipi i II-të Maqedonas

TEMA 1



Fallanga maqedonase

këto reforma përbëheshin nga instalimi i monedhës së vetme të farkuar prej ari, e quajtur stater, ndërkaq e ka përsosur edhe farkimin e monedhave prej argjendi dhe bronzi.

Filipi II me forcën e tij ushtarake ka filluar gradualisht të pushtojë territoret fqinje. Lufërat e tij pushtuese Filipi II i ka filluar kundër Ilirëve, dhe ka pushtuar pjesën më të madhe të tokave të tyre në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Pastaj ka zotëruar me Bregdetin maqedonas dhe atë të Trakisë, e pastaj ka arritur deri në Detin e Zi. Forcimi i shtetit maqedonas ka kërcënuar hegjemoninë e Athinës në Heladë. Këtë vazhdimisht e theksonte filozofi antik dhe oratori i madh Demosteni në fjalimet e tij kundër Filipit II, duke e quajtur të huaj dhe barbar, i cili dëshironte ta mposhtë Heladën. Për t'u mbrojtur nga pushtimet e mëtutjeshme, Athina organizoi koalicion të madh anti maqedonas në poliset Teba, Korint e



Stateri i art Maqedonas

TEMA 1

të tjera me Ilirët, Trakët dhe Pajonët. Në betejën vendimtare tek vendi Heroneja në vitin 338 p.e.s. Filipi II ka korrur fitore mbi Helenët.

Së shpejti më pas, të gjitha shtetet helene kanë njohur pushtetin e Maqedonisë. Prej kur ka zotëruar me Heladën, Filipi II ka thirrur Kongresin gjithëhelen në Korint, në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha shtetet helene përveç Spartës. Në Kongres që vendosur shtetet helene të hyjnë në federatë me Maqedoninë. Pas këtyre luftërave, Filipi II ka filluar përgatitje për luftë kundër Persisë, të cilën e ka konsideruar si armik dhe pengesë për politikën e tij pushtuese. Duke pasur mbështetjen e shteteve helene, ka filluar përgatitje të mëdha luftarake, por gjatë përgatitjeve në vitin 336 p.e.s. u vra me komplot, në oborr, gjatë kohës së dasmës së vajzës së tij Kleopatra.

Si që formuar shteti i vjetër maqedonas?

Cilat ishin reformat e Filipit II?

Detyrë: Hartoni projekt për Filipin II.



Maqedonia gjatë kohës së Filipit të II-të Maqedonas

TEMA 1

SHTETI MAQEDONAS GJATË KOHËS SË ALEKSANDRIT III MAQEDONAS

ARDHJA E ALEKSANDRIT III NË FRONIN MAQEDONAS

Fuqinë më të madhe shteti maqedonas e arriti gjatë kohës së qeverisjes së djalit të Filipit II, mbretit Aleksandrit III Maqedonas (336-323 p.e.s.), i cili meqë njihej si pushtues i madh fitoi epitelin I Madh. Aleksandri trashëgoi babanë e tij në moshën njëzetvjeçare. Shquhej për nga aftësitë e mëdha, energjinë e fuqishme dhe vullnetin. Në oborrin mbretëror mësues kishte filozofin helen Aristotelin. Në moshën 18 vjeçe ka shoqëruar babin e tij në betejën e Hajronesë. Aleksandri nga babai i tij ka trashëguar jo vetëm idenë për beteja pushtuese drejt Azisë, por edhe ushtrinë maqedonase të përgatitur mirë, e cila ka qenë e aftë të realizojë pushtime të atilla. Menjëherë pas marrjes së fronit Aleksandri ka filluar të përgatitet për luftë kundër Persisë, e cila do ta çmojë si një prej prijësve ushtarak më të mëdhenj të shekullit të vjetër.

Në çfarë kushtesh u edukua Aleksandri III?



Aleksandrit III Maqedonas

LUFTËRAT PUSHTUESE TË ALEKSANDRIT III KUNDËR PERSISË

Pasi që i shuajti kryengritjet e shteteve helene, Aleksandri III ka filluar me realizimin e planit të paramenduar nga ana e babait të tij për ekspeditë luftarake kundër Persisë. Kështu, në pranverën e vitit 334 p.e.s. Aleksandri me ushtri jo shumë të madhe, por të trajnuar dhe të armatosur me 30.000 këmbësorë dhe pesë mijë kalorës është nisur në ekspeditë luftarake kundër Persisë, e cila aso kohe nuk ka pasur fuqinë të cilën e kishte në shekullin e kaluar. Beteja më e madhe luftarake me Persinë ka ndodhur në lumin Granik në Azinë e Vogël në vitin 334 p.e.s., në të cilën betejë Aleksandri ka korrur fitoren e parë, edhe pse ushtria e tij ka qenë dy herë më e vogël se ajo persiane.

Pas fitores në Granik, një pjesë e madhe e Azisë së Vogël ka rënë nën pushtetin maqedonas. Pastaj Aleksandri është drejtuar kah Siria, ku në qytezën Is, e ashtu quajtur “Porta e Sirisë” në vitin 333 p.e.s. është zhvilluar betejë e re e madhe, në të cilën ushtria persiane është komanduar personalisht prej mbretit persian Darij III. Këtu persianët përsëri kanë pësuar disfatë, ndërsa mbreti Darij mezi ka shpëtuar duke u arratisur. Pas kësaj beteje e gjithë Siria dhe Fenikia i janë dorëzuar Aleksandrit pa rezistencë, përpos qyteti Tir, i cili është pushtuar pas një rrethimi disamujorë. Pas këtyre fitoreve, përmes Palestinës, Aleksandri është drejtuar kah Egjipti. Në Egjipt ishte pritur si çlirues, ndërsa perënditë egjiptiane e kanë shpallur për



Beteja e Is-ës


djalë të perëndisë Amon. Gjatë kohës së qëndrimit në Egjipt, me rastin e derdhjes së lumit Nil, Aleksandri ka dhënë urdhër të ndërtohet qyteti i ri i quajtur sipas emrit të tij Aleksandria, i cili për kohë të shkurtër është zhvilluar në port të madh, qendër kulturore tregtare e Egjiptit.

Pas një kohe të shkurtër Aleksandri përsëri u kthye në Azi, me çrast në betejë të re, afër qytetit Niniva, te vendi Gavgamela në bregun e lumit Tigër në vitin 331 p.e.s. ushtria persiane përsëri u mund. Darij arriti të shpëtojë duke u arratisur, por pas një kohe të shkurtër u vra nga njerëzit e tij. Pas kësaj fitoreje Mesopotamia me qytetet persiane dhe kryeqytetet

TEMA 1

Babiloninë, Suza, Persepol, Ekbatana etj., u dorëzuan pa luftë. Pas vdekjes së Darit III iu dha fund dinastisë qeverisëse Amenehidi në Persi, ndërkaq në të njëjtën kohë ishte edhe fundi i shtetit persian.

Përshkruaji betejat më të mëdha ndërmjet Aleksandrit III dhe Persisë?



Betejat luftarake dhe luftimet e Aleksandrit të III-të Maqedonas

EKSPEDITA LUFTARAKE E ALEKSANDRIT NË INDI

Pas fitoreve të mëdha kundër Persisë, mbreti Aleksandër ka vendosur të vazhdojë pushtimin në Lindje, të pushtojë Indinë, pasuria e madhe e së cilës e ka tërhequr. Ai në vitin 327 p.e.s. me ushtri të madhe, e përbërë prej maqedonasve dhe popujve tjerë të cilët kanë qenë në përbërje të shtetit maqedonas, është nisur nëpërmjet Turkmenistanit në Indi. E ka kaluar lumin Ind dhe në Penxhap e ka mundur ushtrinë e mbretit indian Por. Pas këtyre sukseseve, Aleksandri është përgatitur të pushtojë luginën e lumit Gang, por këtu ushtria e lodhur nga ekspeditat e mëdha luftarake refuzoj t'i bindet dhe nuk ka dashur të shkojë më tutje. Prandaj Aleksandri ka organizuar kthimin e ushtrisë së tij nëpër lumin Ind kah brigjet e Oqeanit Indian. Këtu Aleksandri ka urdhëruar ushtria të ndahet në dy pjesë. Njëren pjesë e ka dërguar në brigjet nëpërmjet Oqeanit Indian kah Gjiri Persian, ndërsa me pjesën tjetër vetë është nisur nëpër tokë në Perëndim afër bregdetit të oqeanit, dhe përfundimisht në vitin



Beteja kundër mbretit të Indisë Por

325 p.e.s. me të dy pjesët e ushtrisë së tij ka arritur në Babilon. Ky ka qenë edhe fundi i betejave pushtuese të Aleksandrit të Maqedonisë.

Pse Aleksandri III ka ndërprerë pushtimin e mëtutjeshëm në Indi?

RREGULLIMI I SHTETIT

Pas përfundimit të pushtimeve Mesopotamia u bë qendër e një shteti të madh me kryeqytet në Babiloni. Shteti i madh i popujve, konfesioneve dhe gjuhëve të ndryshme paraqiste një konglomerat jo homogjen. Në atë shtet të madh skllavopronar Aleksandri ka tentuar të imponojë si gjuhë të përgjithshme shtetërore gjuhën greke. Qëllimi i Aleksandrit ka qenë të bëjë përzierjen e popujve të nënshtruar lindorë me maqedonasit dhe grekët. Me përzierjen e të gjithë këtyre popujve dhe kulturave të tyre, Aleksandri ka menduar të arrijë unitet më të madh të brendshëm në shtetin multinacional maqedonas. Për ta arritur këtë, në shtetet e pushtuara ka ndërtuar 80 qytete tjera, prej të cilëve numri më i madh kanë mbajtur emrin e tij. Në shërbimet shtetërore ka emëruar, përpos maqedonas dhe grekë edhe përfaqësues të popujve të nënshtruar. Ka mbështetur martesat e ushtarëve maqedonas me persiane “martesë ndërmjet Evropës dhe Azisë” ndërkaq vetë është martuar me vajzën e mbretit persian Darit III. Në oborrin e tij Aleksandri ka instaluar ceremonial dhe ka veshur veshje orientale, ndërkaq këtë e ka kërkuar edhe nga maqedonasit.

Aleksandri III i Maqedonisë qe shpallur si “mbret i mbretërve”. Ka pasur për qëllim të zgjerojë shtetin e tij edhe drejt Detit Adriatik, Arabisë dhe Afrikës Veriore, por papritur ka vdekur shumë i ri në vitin 323 p.e.s.

Pas vdekjes së Aleksandrit kanë filluar luftërat ndërmjet dinastive rreth fronit të shtetit maqedonas, për çka pas 20 vjetësh shteti është shpërbërë në më shumë shtete të pavarura. Ndër shtetet e reja të formuara janë krijuar tre shtete më të mëdha, në të cilat janë përforcuar dinasti të reja mbretërore, edhe atë: Ptolomejët në Egjipt, Selektividët në Siri dhe Antagonidët në Maqedoni. Këto shtete të reja janë quajtur shtete helene.

Në cilën mënyrë ka menduar Aleksandri të arrijë unitet të brendshëm në shtetin e tij të madh? Harto projekt lidhur me Aleksandrin III dhe pushtimet e tij.

TEMA 1

KULTURA E MAQEDONISË ANTIKE

PERËNDITË DHE SIMBOLET MAQEDONASE

Maqedonasit antikë kanë besuar në fuqi të ndryshme mbinatyrore. Sipas atyre besimeve, kanë pasur më shumë kulte, ndërsa më të përhapura kanë qenë kulti për Diellin dhe ujërat, duke i konsideruar si perëndi u kanë dhënë sakrifica. Nga besimet kanë rezultuar edhe një numër i madh i simboleve karakteristike, ndër të cilat më të përhapura kanë qenë ylli maqedonas simbol i civilizimit lindor të cilin e ka pushtuar Aleksandri dhe luani si simbol i pushtetit dhe fuqisë. Përpos kësaj, kanë qenë të pranishme edhe kulti për cjapin, ujkun dhe qenin.

Maqedonasit antikë kanë besuar në shumë zota, por edhe pse



Ylli maqedonas



Dion

perënditë e tyre kanë qenë të afërta me atë helene megjithatë janë dalluar prej tyre. Perëndia më e lartë ka qenë perëndia e qiellit Diosi. Për nder të tij nga ana e mbretit maqedonas Arhellaj I ishte ndërtuar tempulli i njohur në qytetin Dion ku maqedonasit antikë i kanë organizuar Lojërat Olimpikë. Ma ka qenë perëndesha kryesore e luftës dhe luftimit. Perëndesha e bukurisë ka qenë Zeirene. Giga ka qenë perëndesha mbrojtëse, ndërsa Diosi ka qenë perëndi e pjellorisë, kënaqjes dhe verës. Stërgjyshi i familjes mbretërore ka qenë gjysmë perëndia Heraklea. Maqedonasit kanë respektuar dy perëndi të luftës, Ksand dhe Taul.

TEMA 1



Menada Tetovare

Maqedonasit kanë pasur edhe kalendarin e tyre i cili ka pasur 12 muaj, festat e tyre sipas kalendarit të cilat i kanë përcjellë në ditë të caktuara të vitit, ndërkaq perëndive u kanë dhënë viktima dhe janë lutur në tempuj.

Për shkak se në lojërat Olimpike kanë pasur të drejtë të marrin pjesë vetëm helenët, ndërkaq maqedonasit nuk kanë qenë helenë, mbreti maqedonas Arhelaj I ka themeluar lojërat Olimpike maqedonase në qytetin Dion nën malin Olimp, të cilat kanë zgjatur 9 ditë, ndërsa janë zhvilluar gara në fushën e atletikës dhe muzikës. Çdo ditë i është dedikuar ndonjë muze.

Cilat janë perënditë më të rëndësishme maqedonase?

Pse maqedonasit kanë organizuar lojërat e tyre Olimpike?

GJUHA MAQEDONASE


Maqedonasit antikë si popull i veçantë kanë pasur gjuhën e tyre të veçantë me origjinë indoevropiane e cila është dalluar nga gjuha helene. Nga ajo gjuhë deri në ditët e sotme janë ruajtur 150 glose (fjalë). Gjuha maqedonase nuk ka mbijetuar për shkak se nuk është formuar alfabeti i saj. Mbretërit maqedonas duke pasur para vetes synime me shtrirje të gjerë, në kontaktet e përditshme me mbretëritë e afërta dhe më të largëta, fise dhe qytete, ishin të detyruar të komunikonin me gjuhën gjerësisht të përhapur helene dhe alfabetin e asaj kohe.

Pse nuk është ruajtur gjuha maqedonase?

TEMA 1

MBETJET MATERIALE TË MAQEDONASVE ANTIKË

Falë gërmimeve arkeologjike në territorin e Maqedonisë, janë zbuluar mbetje të qyteteve Ajga, Pella; Dion, Evrop, Filii, Amfipol etj. Qytetet janë zbuluar me ndërtime të ndryshme siç janë agoret (sheshet), tempujt dhe pallatet e qyteteve. Maqedonasit kanë parapëlqyer stilin dorian dhe atë jonian në arkitekturë. Janë zbuluar edhe më shumë fortesat ushtarake maqedonase, të ndërtuara në pozita kryesore me blloqe të mëdha të gdhendura në formë drejtkëndëshi. Teatrot e tyre, të përshtatur sipas nevojave të tyre personale, përpos për shfaqje teatrore, janë përdorur edhe për tubime publike, parada dhe rite të caktuara. Në hapësirat e Maqedonisë janë gjetur edhe më shumë nekropole të rëndësishme në Trebenishtë, pastaj nekropoli në Sindos në Selanik, varrezat mbretërore në Vergina, varrezat në Sellcen e Poshtme etj. Varrezat maqedonase janë përbërë prej fasadës ballore në stil dorian ose jonik, paradhomës dhe dhomës. Varrezat kanë qenë të mbuluara me mogila të mëdha varrëzore, për të mos u vjedhur por edhe për shkak të traditës së lashtë bujqësore - patriarkale. Mbretërit maqedonas duke filluar nga Aleksandi I Filhelen, kanë farkuar monedhat e tyre prej bronzi, argjendi dhe ari. Në figurat e monedhave janë hasur figura të ndryshme të mitologjisë, botës bimore dhe shtazore, si dhe figura të mbretërve maqedonas. Mbretërit maqedonas në veçanti janë të njohur me dijademet mbretërore specifike, ndërsa popullsia me kapelën kausija.



Diadema mbretërore maqedonase



*Zbulime të arit nga
Varreza e Filipit*

Çfarë mbetje arkeologjike janë ruajtur?

Harto projekt lidhur me Lojëra Olimpikë Maqedonase.



Cilat simbole i njeh në fotografi?

MAQEDONIA NËN SUNDIMIN ROMAK

PARA RREZIKUT TË PËRLESHJEVE MAQEDONO-ROMAKE

Edhe krahas luftërave me shtetet helene të cilave u kanë ndihmuar edhe shtetet tjera helene, Maqedonia (shteti i Antagonidëve) në shek. III p.e.s., në marrëdhëniet ndërkombëtare ende ka paraqitur forcë të rëndësishme politike, dhe shtetin më të fuqishëm Ballkanik. Për forcimin e saj kanë kontribuar mbretërit maqedonas të dinastisë së Antagonidëve Antigoni Dosi dhe Filipi V (221-179 p.e.s.). Gjatë kësaj kohe, në pjesën perëndimore të Mesdheut kanë luftuar për pushtet Roma dhe Kartagjena. Roma me synimet e saj sunduese gjithnjë e më tepërka paraqitur rrezik për Maqedoninë. Për këtë shkak, Filipi V ka bërë pakt me Kartagjenën, për luftë të përbashkët kundër Romës. Kjo ka rezultuar me përkeqësimin e marrëdhënieve ndërmjet Maqedonisë dhe Romës, ndërkaq më vonë ka rezultuar edhe me luftë ndërmjet tyre. Gjatë kësaj, Romakët kundër Maqedonisë kanë përdorur edhe pakënaqësinë e shteteve helene kundër pushtetit maqedonas. Lufta ndërmjet Maqedonisë dhe Romës ka shpërthyer në vitin 215 p.e.s. Gjithsej janë zhvilluar tre luftëra maqedonase - romake.



Mbreti maqedonas Filipi V

Si ka qenë pozita e Maqedonisë në shek. III p.e.s.?

LUFTËRAT MAQEDONO-ROMAKE

Gjatë luftës së parë Maqedono-Romake prej vitit 215 deri në vitin 205 p.e.s. pjesëmarrja romake ka qenë e kufizuar vetëm me dërgimin e flotave në bregdetin e Egjeut. Në luftën kundër Maqedonisë pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ka pasur koalicioni anti maqedonas me paktin Ajtolik, i cili është dashur të pamundësojë që ajo t'i dërgojë ndihmë udhëheqësit kartagjenas Hanibalit. Lufta nuk ka shkaktuar ndonjë ndryshim më esencial dhe ka përfunduar me paqen e lidhur ndërmjet paktit Maqedonas dhe atij të Ajtolëve.

Gjatë Luftës së Dytë Maqedono-Romake nga viti 200 - 193 p.e.s. ka ardhur deri te përleshja e drejtpërdrejtë e ushtrisë maqedonase dhe asaj romake. Si shkak formal për këtë luftë ka



Mbreti Persej

shërbyer përfshirja e Filipit V në luftën kundër Trakasve, në territorin e Pargamit në Azinë e Vogël. Pas hyrjes në Maqedoni ushtria romake është kthyer kah Deti Adriatik. Romakëve u janë bashkangjitur edhe Dardanët, Ilirët, Ajtolët dhe Ahajët. Në betejë të madhe në vendin Kinosefale në vitin 197 p.e.s. mbreti Maqedonas Filipi V pësoi disfatë dhe në bazë të paqes së lidhur ka humbur të gjitha territoret e atëhershme jashtë Maqedonisë, ka qenë i detyruar të paguajë dëmshpërblim të madh, të dorëzojë flotën dhe të reduktojë numrin e ushtrisë së tij. Pas vdekjes së Filipit V në pushtet vjen djali i tij Persej (179-163 p.e.s.), i cili ka qenë edhe mbreti i fundit i Maqedonasve antikë. Lufta e Tretë Maqedono-

Romake ka zgjatur prej vitit 171 deri në vitin 168 p.e.s., ndërkaq është zhvilluar me sukses të ndryshueshëm. Vendimtare ka qenë beteja e cila është zhvilluar në vitin 168 p.e.s., ndërkaq ka përfunduar me triumfin definitiv të Romakëve. Me këtë është shkatërruar shteti i Maqedonasve, ndërkaq mbreti Maqedonas Persej me familjen e tij janë çuar në Romë.

Pse janë zhvilluar Luftërat Maqedo-Romake?

MAQEDONIA SI PROVINCË ROMAKE

Pas nënshtrimit, Maqedonia ka qenë e ndarë në katër krahina të cilat kanë pasur njëfarë vetadministrimi. Por krahinave ndërmjet veti u është ndaluar çdo lloj lidhje ekonomike ose politike. Maqedonasve u është ndaluar t'i shfrytëzojnë xeheroret për ar dhe argjend, ndërsa pasuritë maqedonase janë dërguar në Romë.

Pakënaqësinë e Maqedonasve ndaj pushtetit romak e ka shfrytëzuar Andriksi, i cili është prezantuar si djali i mbretit të fundit maqedonas Perseut (Filipi gënjeshtar) dhe në vitin 149 p.e.s. ka ngritur kryengritje të pasuksesshme. Kryengritësit kanë pësuar disfatë dhe Maqedonia në vitin 148 p.e.s., është shndërruar në provincë Romake, me çka e ka humbur edhe atë pavarësi që e ka pasur. Atëherë në Maqedoni u vendos ushtria e përhershme romake, ndërsa me Maqedoninë kanë qeverisur administratorë dhe nëpunës romakë. Në krye të provincës ka qenë drejtuesi romak, i cili ka pasur të gjithë pushtetin ushtarak dhe civil.

Pse është ngritur kryengritja e Andriskut?

TEMA 1

PËRHAPJA E KRISHTERIMIT NË MAQEDONI

Përhapja e krishterimit në Maqedoni ka filluar me udhëtimin misionar fisnik të apostullit Pali, një prej nxënësve të parë të Jezu Krishtit. Kah mesi i shek. I p.e.s., ai disa herë ka qëndruar në Maqedoni, ku ka predikuar krishterimin në mesin e popullsisë lokale. Fillimisht ka predikuar në qytetin Filipi, pastaj ka shkuar në Selanik, prej atje në Ber. E para që ka pranuar krishterimin dhe është konvertuar quhet Lidija nga qyteti Filipi. Pasi që ka fituar mjaft ithtarë, të cilët kanë pranuar krishterimin, apostulli Pali, në Filipi, Selanik dhe në Ber themeloi komuna krishtere. Këto kanë qenë bashkësitë e para krishtere në Maqedoni, por gjithashtu edhe në Evropë. Deri te komunat e krishtere në Filipi dhe Selanik apostull Pali dërgoi tre letra fetare: një për Filipianët, tjetrën për Selanikasit. Me to ka inkurajuar ithtarët e tij të qëndrojnë në mbrojtje të krishterimit, duke u porositur të ruajnë besimin, shpresën dhe dashurinë si të mira më hyjnore.

Apostull Pali në krye të organizimit dhe udhëheqjes së komunës së parë krishtere në Filipi ka vendosur evangjelistin Luka, i cila ka shkruar një nga katër ungjijtë, të cilat janë bazë e mësimin të krishterë.



Ungjëlli i shenjtë Lluka



Apostull Pali

*Çfarë i ka këshilluar apostull Pali të krishterët maqedonas në letrat e tij?
Hulumto dhe zbulo! Pse Maqedonia është shtet Biblik?*

TEMA 2.
MAQEDINIA NË MESJETË

DYNDJET E SLLAVËVE NË MAQEDONI

FISET SLLAVE MAQEDONASE DHE TERRITORET E TYRE

Prej fundit të shek. VI deri në mesin e shek. VII i gjithë territori i Maqedonisë me përjashtim të Selanikut, ishte e banuar nga sllavët. Kolonizimi sllav në Maqedoni ishte përcjellë me shkatërrime të qyteteve maqedonase, kishave krishtere, fortesave, me ç'rast ishin vjedhur dhe demoluar edhe ekonomitë skllavopronare rreth tyre.

Territori i Maqedonisë ishte banuar me më shumë fise sllave. Për numrin më të madh të tyre janë të njohur edhe emrat. Në afërsi të Selanikut është vendosur fisi Sagudati, në perëndim të Selanikut fisi Dragovit, në gadishullin Hallkidiki Rinhidët, në rrjedhën e lumenjve Struma dhe Strumica si dhe në rajonet përreth, Strumjanët, rreth lumit Mesta Smolljanët, ndërkaq në hapësirat rreth qyteteve të sotme Veles, Kavadar, Prilep, Manastir, Kërçovë, Dibër, Ohër, si dhe në Prespë dhe vendet përreth janë vendosur Berzitët.

Trego cilat kanë qenë fiset më të njohura sllave në Maqedoni?

RRETHIMET DHE SULMET SLLAVE NDAJ QYTETIT TË SELANIKUT

Në fund të shek. VII sllavët, vetë ose të bashkuar me Avarët, dy herë kanë tentuar të pushtojnë qytetin e Selanikut, i cili ka qenë qyteti i dytë për nga madhësia në Bizant pas Stambollit. Edhe pse ata kanë përdorur mjete të ndryshme për rrethim, muret e trasha të Selanikut nuk ka qenë e mundshme të pushtohen. Në dekadën e dytë të shek. VII sllavët të bashkuar në lidhje të mëdha fisnore në krye me knezin Hacon për herë të tretë e kanë rrethuar dhe sulmuar Selanikun, por edhe kësaj here nuk kanë pasur sukses ta pushtojnë. Knezi Hacon ishte zënë rob dhe ishte vvarë. Edhe gjatë viteve të ardhshme janë bërë tentime ta pushtojnë këtë qytet por pa sukses. Selaniku edhe më tutje ka ngelur baza e vetme bizantine në territorin e Maqedonisë. Por edhe ky qytet gradualisht është sllavizuar, nën ndikimin e fiseve sllave.

Pse sllavët nuk kanë pasur sukses të pushtojnë Qytetin e Selanikut?



Muret e Selanikut nga koha e mesjetës

KRIJIMI I SKLLAVINIVE MAQEDONASE

Që nga fundi i shek. VI, njëkohësisht me popullimin me fise të veçanta sllave në territorin e Maqedonisë janë paraqitur skllavitë, të cilët i kanë përfaqësuar territoret sllave të fiseve të caktuara sllave. Emrat e tyre i kanë marrë sipas emrave të fiseve. Skllavinia e fisit Berzit, p.sh., është quajtur “Berzitija”, e fisit Dragovit “ Dragovitija” etj. Të gjitha skllavitë në Maqedoni, ishin emëruar me emër të përgjithshëm “skllavitë maqedonase”.

Në gjysmën e dytë të shek. VII fiset maqedonase sllave janë bashkuar në lidhje të madhe fisnore në krye me udhëheqësin e fisit rinhin Prebond. Qëllimi i tyre ka qenë të mënjanojnë pushtetin Bizantin nga qyteti i Selanikut dhe të formojnë shtetin sllav në Maqedoni. Mirëpo Prebondi ishte kapur, ishte çuar në Stamboll ku është likuiduar në vitin 674. Në këtë mënyrë kanë dështuar tentime e sllavëve maqedonas të bashkohen nën pushtetin e Prebondit dhe që në shek. VII të krijojnë shtet.

Ç’kanë paraqitur skllavitë maqedonase?

TEMA 2

RELACIONI I SLLAVËVE NDAJ MAQEDONASVE ANTIKË

Në periudhën e popullimit të sllavëve në Maqedoni, popullata më e madhe autoktone kanë qenë maqedonasit antikë. Gjatë ardhjes së sllavëve në Maqedoni një pjesë e maqedonasve antikë janë tërhequr në qytetet dhe ishujt bregdetar, një pjesë janë vendosur në Traki, ndërsa një pjesë e popullatës së vjetër autoktone të cilët u kanë bërë rezistencë sllavëve, kanë rënë viktima të sulmeve sllave. Një numër i madh i maqedonasve kanë kaluar në anën e sllavëve dhe kanë vazhduar të jetojnë në vendlindjet e tyre. Një numër i vogël i maqedonasve të vjetër autoktonë janë tërhequr në malet dhe atje kanë vazhduar të jetojnë jetën e tyre, duke ruajtur gjuhën e tyre, traditat, kulturën etj. Supozohet se një pjesë e popullatës së tillë të vjetër autoktone janë vllahët.

Maqedonasit antikë, si popull me numër të vogël, gradualisht janë asimiluar nga ana e popullatës sllave me numër më të madh. Nga përzierja e sllavëve dhe maqedonasve, më vonë në gjysmën e dytë të shek. X është krijuar populli i ri sllavo maqedonas, i cili ka hyrë në familjen e popujve sllavo jugor. Maqedonasit antikë sllavëve ua kanë trashëguar jo vetëm kulturën, traditat e tyre por edhe emrat Maqedoni dhe maqedonas, me çka janë dalluar nga popujt tjerë fqinjë Ballkanik.

Sqaroje relacionin e sllavëve me popullatën e vjetër autoktone maqedonase.



Kisha Sh. Dimitri në Selanik

NDRYSHIMET ETNIKE DHE SHOQËRORE - EKONOMIKE

Pas vendosjes së sllavëve në Maqedoni janë bërë ndryshime etnike rrënjësore. Vendbanimet qytetare dhe fshatare, si dhe malet, lumenjtë, liqenet, vende të caktuara etj., kanë marrë emra të ri sllavë ose emrat e vjetër janë sllavizuar. P.sh., qyteti Lihnidis ka marrë emrin e pastër sllav Ohrid, lumi Aksios është quajtur Vardar etj. Emra sllavë kanë marrë edhe malet Bellasica, Ograzhden, Bistra etj. Emra të sllavizuar, kanë marrë qytetet Skupi, i cili u quajt Skopje, Tesalonika - Solun, Astibo - Shtip.

Gjatë kohës së ngulitjes të sllavëve në Maqedoni, së bashku me largimin e pushtetit bizantin u shkatërrua edhe sistemi tani më i vjetër skllavopronar. Në vendet e shkatërruara të ekonomive skllavopronare, janë krijuar shoqëritë fshatare të lira sllave në të cilat si njerëz të lirë kanë jetuar edhe robërit e liruar edhe kolonitë. Më vonë, me zhvillimin e shoqërisë, ka ardhur deri te kalimi i ashtuquajtur i komunave bujqësore në komuna territoriale. Kjo ka rezultuar me pabarazinë pronësore ndërmjet fshatarëve dhe është paraqitur shtresimi i shoqërisë. Si pasojë e kësaj gjatë shek. IX dhe X fshatarët më të pasur janë shndërruar në pronarë feudalë, ndërkaq të varfrit në njerëz të varur. Në këtë mënyrë rregullimi i vjetër i shoqërisë sllave i kanë liruar vend rregullimit të ri shoqëror feudal.

Çfarë ndryshimesh etnike dhe shoqërore-ekonomike janë shkaktuar në Maqedoni pas ardhjes së sllavëve?

**RËNIA E SKLLAVINIVE MAQEDONASE NËN
SUNDIMIN BULLGAR DHE BIZANTIN**

Nga fundi i shek. VII Bizanti ka forcuar sulmet luftarake kundër sllavëve maqedonas. Mirëpo, skllavinitë maqedonase, duke u bashkuar në lidhje të mëdha fisnore, me sukses u kanë bërë ballë sulmeve bizantine të cilat veçanërisht janë shpeshtuar gjatë shek. VIII.


Nga gjysma e parë e shek. IX skllavinitë maqedonase u janë ekspozuar edhe sulmeve të fuqishme bullgare. Si pasojë e kësaj gjatë shek. IX dhe fillimit të shek. X pjesa më e madhe e Maqedonisë është pushtuar nga Bullgaria, ndërsa pjesa tjetër ka rënë nën pushtetin bizantin.

TEMA 2

PARAQITJE DHE ZHVILLIMI I ALFABETIT SLLAV DHE I KULTURËS SLLAVE

NEVOJA PËR KRIJIMIN E ALFABETIT SLLAV

Kur e kanë banuar sllavët Gadishullin Ballkanik kanë ardhur në Maqedoni me besimin e tyre në më shumë zota dhe me traditat e tyre të vjetra. Njohuritë e para lidhur me krishterimin i kanë zbuluar dhe pranuar nga ana e maqedonasve antikë autoktonë. Nën ndikimin e tyre, Sllavët maqedonas filluan të pranojnë krishterimin. Bizanti për t'i nënshtruar sllavët dhe për t'i shndërruar në vasalë të tij është shërbyer me përhapjen e krishterimit. Prandaj paralelisht me sulmet luftarake ka organizuar konvertimin e atyre sllavëve të cilët kanë rënë nën pushtetin bizantin. Por, konvertimi ka shkuar shumë ngadalë për shkak se për këtë janë nevojitur shumë libra kishtarë të shkruara në gjuhën sllave, për shkak se atëherë sllavët ende nuk kanë pasur alfabetin tyre, por kanë shkruar me vrima- viza. Prandaj konvertimi masovik i sllavëve ka filluar vetëm atëherë kur Kirili ka krijuar alfabetin sllav të quajtur glagolicë.



Format më të vjetra të shkronjave glagolike

Prej kur sllavët maqedonas fillimisht janë njoftuar me krishterimin?

KRIJIMI I SHKRIMIT DHE ALFABETIT SLLAV

Krijues të alfabetit të parë sllav (gllagolicës) dhe themelues të alfabetit dhe kulturës sllave kanë qenë vëllezërit Konstantin (Kiril) dhe Metodi. Ata janë lindur në Selanik në fillim të shek. IX, dhe me siguri kanë qenë me origjinë sllave. Prindërit e tyre Llav dhe Marija kanë pasur familje të pasur, dhe u kanë mundësuar fëmijëve të tyre të fitojnë arsimim solid, i cili u ka mundësuar të fitojnë detyra të larta shtetërore në Bizant. Vëllai më i madh Metodi pas përfundimit të shkollimit, ka kryer obligime ushtarake, në rajonin e Selanikut.

Në moshën njëzetvjeçare Metodi nga ana e perandorit të Bizantit ka marrë gradën vojvodë dhe është dërguar të udhëheqë me principatën sllave në Maqedoni, në rajonin e



*Sh. Kirili dhe. Sh. Metodi
(miniaturë)*

Strumicës dhe Bregallnicës me vendbanimet . Me principatën ka udhëhequr 10 vjet, brenda viteve 845 - 855. Në ndërkohë, me qëllim që t'i ndihmojë vëllait më të vjetër Metodit, pas kryerjes së Shkollës së Lartë Magnaura në Stamboll, për punë misionare është dërguar edhe vëllai më i vogël Konstantin i cili më vonë bëhet i njohur me emrin e tij prej monarku Kiril. Gjatë kryerjes së misionit në Bregallnicë, Kirili me ndihmën e vëllait Metodi ka krijuar alfabetin sllav - gllagolicën në vitin 855. Ajo përbëhej prej 38 shkronjave. Në kohën që ka vepruar në mesin e sllavëve, Kirili ka pagëzuar 54.000 sllavë, dhe gjithashtu ka shkruar edhe “Librin për gjuhën sllave”. Në këtë mënyrë në këtë pjesë të Maqedonisë, Kirili së bashku me vëllanë e tij Metodi kanë vendosur bazat e letërsisë dhe alfabetit sllav, si dhe bazat e kishës sllave, për shkak se në kishat ishte instaluar edhe predikimi në gjuhën sllave. Prandaj Maqedonia në shkencë me të drejtë konsiderohet si mëmëdheu i alfabetit dhe i kulturës sllave.

Në vitin 855 ka pushuar puna e vëllezërve Kirili dhe Metodi si drejtues dhe misionarë në rajonet e Bregallnicës dhe Strumicës. Metodi është larguar të jetojë në malin Olimp në Azinë e Vogël, ku në qetësinë e manastirit tërësisht i është dedikuar shkrimit dhe përkthimit të librave nga gjuha greke në sllave.

Në vitet 855 - 856 Kirili u dërgua nga ana e perandorit bizantin në mision të ri me punë në mesin e saracenëve në Bagdad. Pas misionit të përfunduar me sukses, ka shkruar te Metodi në malin Olimp.

TEMA 2

Në vitin 860 vëllezërit Kirili dhe Metodi u dërguan me punë misionare tek hazarët të cilët kanë jetuar përreth Detit të Zi. Pas misionit të suksesshëm të Hazarit në vitin 861 Metodi përsëri është kthyer në malin Olimp dhe është bërë drejtues i manastirit, ndërsa Kirill është larguar për Stamboll.

Përshkruaj misionin e Bregallnicës të Kirilit dhe Metodit!

MISIONI I MORAVËS I KIRILIT DHE METODIT

Në ndërkohë në Stamboll kanë arritur emisarë të knjazit të Moravisë Rostisllav, të cilët i kanë dorëzuar perandorit Mihail III lutje nga ana e Rostisllavit me të cilën ai ka kërkuar t'i dërgojë njerëz të arsimuar, të cilët në kishat e Moravisë do të instalojnë predikim në gjuhën sllave të cilën e kupton populli. Misioni në Moravinë e Madhe perandori ua ka besuar tanimë misionarëve të dëshmuar Kirilit dhe Metodit. Për nevojat e sllavëve të Moravisë, ata e kanë plotësuar dhe përshtatur alfabetin sllav të krijuar në tokën maqedonase dhe prej kur kanë shkruar dhe përkthyer numër të madh të librave në gjuhën sllave, në vitin 863 me nxënësit e përzgjedhur nga ana e tyre Klimentin, Naumin etj., janë nisur në Moravinë e Madhe. Kirili dhe Metodi vetëm sa kishin filluar të korrin suksese gjatë fillimit të predikimit sllav, kundër tyre janë hedhur priftërinjtë gjermanë, të cilët kanë predikuar në gjuhën e panjohur për popullin në gjuhën latine. Së shpejti Kirili dhe Metodi bashkë me nxënësit e tyre u ftuan nga ana e Papës Nikolla në Romë të japin raport lidhur me punën e tyre në Moravinë e Madhe. Mirëpo, kur kanë arritur në Romë solemnisht janë pritur nga Papa i ri Adriani II dhe nga qytetarët e Romës. Papa madje ka lejuar të mbahet liturgji sllave në më shumë kisha të Romës. Njëkohësisht me urdhër të papës, Metodi u dekorua me akt të lartë kishtar (arqipeshkv) ndërsa gradë kishtari kanë fituar edhe Klimenti, Naumi dhe nxënës të tjerë.

Gjatë qëndrimit në Romë, Konstantin Filozofi është sëmurë. Para se të ndërrojë jetë në vitin 869 ai është bërë murg dhe ka marrë emrin e murgut Kiril. U varros në kishën Shën Klimenti në Romë me të gjitha nderimet që u janë bërë papëve të Romës.

Metodi me nxënësit e tij besnik vazhdoi veprimtarinë misionare në Moravinë e Madhe. Gjatë kësaj ata vazhdimisht janë penguar në kryerjen e punës së misionarit nga ana e



Shën Kirili



Shën Metodi

klerit gjerman. Edhe përpos kësaj Metodi deri në vdekjen e tij (885) me sukses u është kundërvënë klerit gjerman, për çka ka qenë plotësisht i mbështetur nga ana e nxënësve të tij besnikë.

Çfarë rëndësie ka misioni i Kirilit dhe Metodit në Moravinë e Madhe?

SHKOLLA LETRARE E OHRIT

THEMELIMI I SHKOLLËS LETRARE TË OHRIT

Pas vdekjes së vëllezërve Kirili dhe Metodi veprimtarinë e tyre e kanë vazhduar nxënësit e tyre, të cilët të përndjekur dhe të persekutuar nga ana e kishtarëve gjermanë të Moravisë së Madhe kanë qenë të detyruar të arratisen në jug të Gadishullit Ballkanik. Në Moravi në vitin 885 ka pasur mbi 200 nxënës. Prej tyre Klimenti, Naumi, Sava, Angellarij etj., kanë ardhur në Bullgari ku në pushtet ka qenë knjaz Borisi. Borisi ka pasur nevojë të madhe për njerëz të arsimuar për të realizuar politikën e tij në rajonet e sapopushtuara maqedonase dhe shqiptare. Për këtë shkak në vitin 886 Klimenti u dërgua nga ana e Knjazit Boris me punë misionare në rajonin e Kutmiçevës. Ky rajon ndodhej në Maqedoninë Jugperëndimore dhe në pjesën e Shqipërisë Jugore, ndërsa kryeqendra kanë qenë Ohri dhe Devolli.

Qyteti i Ohrit që nga fillimi ishte shndërruar në një nga selitë kryesore të veprimtarisë arsimore të Klimentit. Përderisa në pushtet ka qenë Borisi, Klimenti në Ohër ndërtoi më

TEMA 2



Shën Klimenti dhe Shën Naumi, Ikona nga shek. XIV

shumë kisha në të cilat është instaluar mesha në gjuhën sllave. Me këtë Klimenti ka vendosur themelet e shkollës sllavo maqedonase dhe të kishës sllave.

Për kryerjen më të suksesshme të veprimtarisë arsimore në rajonin e Kutmiçevës, knjazi Boris, Klimentit i ka ndarë tre pallate luksoze në krahinën e Devollit, të cilat Klimenti i ka shndërruar në shkolla sllave. Boris, Klimentit i ka ofruar edhe vende për pushim në Ohër, ku Klimenti ndërtoi edhe manastirin e tij Shën Pantelejmonin, i cili është bërë qendër e fitimit të arsimit më të lartë kishtar. Me këtë Klimenti qysh si mësues ka vendosur themelet e Shkollës letrare të Ohrit, e cila gradualisht është ngritur në institucion i lartë dhe i zhvilluar arsimor, d.m.th. në qendër të universitetit të parë sllav që është themeluar ndonjëherë. Prandaj me të drejtë quhet edhe si Universiteti i Klimentit.

Si rezultat i veprimtarisë intensive arsimore, Klimenti ka pasur sukses që për një kohë të shkurtër të aftësojë një numër të madh priftërinjsh sllavë, mësues dhe veprimtarë të tjerë kulturorë. Numri i tyre ka qenë rreth 3500. Përveç se në Ohër ata kanë vepruar edhe nëpër të gjitha rajonet maqedonase si priftërinj, mësues, shkrimtarë, artistë etj. Me këtë, në kishat maqedonase, liturgjia e pa kuptueshme greke, të cilën e kanë predikuar priftërinjtë bizantinë, u zëvendësua me atë sllave.

Duke qëndruar më shpesh në Ohër, Klimenti atje ka zhvilluar veprimtarinë e frytshme si shkrimtar. Nga penda e tij janë krijuar mbi 50 vepra letrare të cilat kanë shërbyer si bazë për ndërtimin e literaturës dhe kulturës maqedonase. Prandaj edhe është quajtur i Ohrit. E gjithë kjo ka mundësuar Ohri të shndërrohet në fidanishte e kulturës sllave, meqë nga ky qytet nëpër Maqedoni dhe në mbarë botën sllave janë dërguar numër i madh i punimeve letrare sllave.

Cila është rëndësia e Shkollës Letrare të Ohrit?



Kisha Shën Naum

EMËRIMI I KLIMENTIT PËR IPESHKËV DHE VEPRIMTARIA E SHËN NAUMIT NË MAQEDONI

Kah fundi i shek. IX sundues i ri i Bullgarisë është bërë Simeoni. Sapo ka ardhur në pushtet në vitin 893 ai ka emëruar Klimentin ipeshkëv në Dioqezën Veliçka. Qyteti i vjetër krishterë Tiveriopoli (Strumica) është bërë selia e Dioqezës së Klimentit. Klimenti i Ohrit me të drejtë konsiderohet si ipeshkëv i parë sllav. Nën udhëheqjen e tij instalohet liturgjia në gjuhën sllave në kishat edhe në territoret e pushtuara maqedonase dhe shqiptare, nga ana e Bullgarisë.

Në vendin e zbrazët për mësues në krahinën e Kutmiçevicës, Simeoni e ka emëruar Naumin i cili ka qenë bashkëpunëtori më i afërt i Klimentit. Si Klimenti, ashtu edhe atij iu ofrua të posedojë pjesë të pasura në Liqenin e Ohrit. Në vetë bregun e Liqenit të Ohrit, Naumi ndërtoi manastir, i cili është quajtur sipas emrit të tij Shën Naum.

Veprimtarinë e mësuesit Naumi gjithashtu e ka ushtruar më së shumti në qytetin e Ohrit. Edhe ai ka merita të mëdha që Ohri aso kohe të rritet në qytetin më të zhvilluar kishtar, arsimor dhe kulturor në Ballkan, por edhe më gjerë. Nën udhëheqjen e tij janë krijuar një numër i madh veprash kishtare, arsimore dhe kulturore. Prandaj me të drejtë është quajtur i Ohrit. Rreth vitit 900 Naumi është bërë murg dhe është tërhequr në manastirin e tij në Shën Arhangel, për të formuar vëllazërinë e murgjve.

TEMA 2

Naumi i Ohrit iu bë bashkëpunëtor i besuar Klimentit deri në momentin e vdekjes së tij në vitin 910. Në varrimin e tij ka marrë pjesë edhe bashkëpunëtori i tij më i afërt Klimenti i Ohrit. Gjashtë vjet më vonë, në vitin 916 ndërron jetë edhe Klimenti. Ai u varros në manastirin Shën Pantelejmon, në varrin të cilin vetë e kishte përgatitur nga ana e djathtë e pjesës së përparme të altarit. Manastiri sot është restauruar dhe në të janë bartur eshtrat e Shën Klimentit.

Çfarë rëndësie ka viti 893 për Shën Klimentin dhe Shën Naumin?



Shën Pantelejmoni në Pllaoshnik

LËVIZJA E BOGOMILËVE

PARAQITJE E MËSIMIT BOGOMIL



Predikues Bogomil me dëgjuesit e vet

Mësimi i Bogomilëve për herë të parë është paraqitur në gjysmën e parë të shek. X në pjesën e Maqedonisë, e cila ka qenë nën pushtetin bullgar gjatë kohës së mbretit bullgar Petar. Predikues kryesor dhe udhëheqës i bogomilëve maqedonas ka qenë prifti Bogomil. Veprimtarinë e tij kryesisht e ka zhvilluar në krahinat e Velesit dhe Prilepit. Për këtë flasin edhe gojëdhënat popullore të shkruara dhe emrat e ruajtur të më shumë fshatrave, lumenjve, fushave etj., të emëruara nën ndikimin e emrit të priftit Bogomil dhe mësimit të tij. Të këtilla, p.sh., janë emrat e

fshatit Bogomila, emri i fushë së Bogomilës, si dhe emrat e malit Babuna, lumit Babuna, për shkak se bogomilët kanë qenë të njohur edhe si “babunë”.

Ku është paraqitur për herë të parë mësimi dhe lëvizja e bogomilëve?

ESENCA E MËSIMIT BOGOMIL

Bogomilizmi është formuar si lëvizje fetaro-filozofike dhe sociale. Gjatë kohës së ekzistimit të saj pesë vjeçar, bogomilizmi vazhdimisht është avancuar dhe, varësisht nga kushtet shoqëroro-ekonomike dhe politike ka ndryshuar karakterin e vet.

Me forcimin e sistemit feudal, fshatarët e lirë gjithnjë e më tepër u shndërruan në të varfër dhe të mjerë, ndërkaq prej mundit të tyre gjithnjë e më shumë janë pasuruar pjesëtarët e aristokracisë dhe kishës, të cilët janë ngritur në zotërues të mëdhenj feudalë. Feudalët - të shenjtë dhe kishtar- kanë bërë jetë luksi dhe të shthurur, ndërkaq fshatarët të varfër kanë fundosur në varfëri. Privimi nga liria personale, si dhe eksploatimi i paparë feudal kanë shkaktuar pakënaqësi dhe rezistencë të popullit maqedonas kundër rregullimit shoqëror feudal. Kjo rezistencë e popullit kundër eksploatimit feudal në Maqedoni është formuar si lëvizje fetare, e njohur në histori me emrin lëvizja e Bogomilëve.

Më të ashpra kanë qenë sulmet e bogomilëve kundër kishës, e cila në cilësinë e institucionit feudal është shndërruar në vegël të shtetit bullgar për mbajtjen nën nënshtrim vasalët maqedonas.

TEMA 2

Baza e mësimit bogomil ka qenë dualizmi fetar. Sipas mësimit fetar bogomil, bota paraqet luftë të përhershme ndërmjet dy forcave të gjithësisë - të mirës dhe të keqes, ndërkaq në fund, sipas tyre, do të fitojë e mira. Forca e së mirës, përkatësisht krijimi, sipas tyre, ka qenë Zot, ndërkaq forca e të keqes, respektivisht shkatërrimit ka qenë djalli. Të gjithë botën materiale, po edhe vetë trupin e njeriut (por jo edhe shpirtin) e ka krijuar djalli, dhe ai zotëron me atë. Sipas bogomilëve Zoti është krijuesi i botës së padukshme (shpirtërore). Prandaj bogomilët kanë qenë kundër kishës, pronave dhe shtetit. Ata kanë dashur gjithë shoqërinë feudale ta paraqesin si pjesë të djallit. Atij i shërbejnë feudalët, fetarët e lartë dhe mbretërit. Prandaj u kanë bërë thirrje fshatarëve të mos punojnë në pronat e feudalëve dhe të mos u nënshtrohen feudalëve, pushtuesit dhe kishës. Ata kanë kërkuar të merret toka nga manastiret dhe feudalët dhe t'u shpërndahet edhe fshatarëve të varfër. Pikërisht për këtë shkak populli i shtypur ka pranuar mësimin bogomil.



Djalli para derës së ferrit



Përmendore varri në Bosnjë

Bogomilët janë ndarë në besimtarë të përkryer, besimtarë të rëndomtë dhe dëgjues. Të përkryerit kanë qenë interpretuesit më të mira të mësimit bogomil. Jeta e tyre ka qenë rreptësisht asketike. Janë ushqyer në mënyrë vegjetariane, nuk janë martuar, dhe kohën e tyre e kanë kaluar me mësime lutjesh dhe predikim. Besimtarët e rëndomtë nuk kanë qenë të detyruar plotësisht t'i përmbahen jetës asketike, por edhe ata në jetën e tyre kanë pasur kufizime të caktuara. Dëgjuesit kanë marrë pjesë vetëm në predikimet por jo edhe gjatë riteve fetare. Bogomilët i kanë hequr ikonat, nuk kanë respektuar kryqin dhe nuk kanë ndërtuar kisha. Ata kanë qenë të organizuar në komuna religjioze.

Sqaro mësimin e bogomilëve?

PËRHAPJA E LËVIZJES BOGOMILE DHE PËRNDJEKJA E BOGOMILËVE

Përhapja e shpejtë e idesë bogomile ka qenë shkak që mbreti Petar i Bullgarisë të marrë masat më të rrepta për të çrrënjësuar këtë lëvizje të rrezikshme heretike. Në këtë drejtim ai ka marrë mbështetje edhe nga ana e patriarkut Teofilakt, por bogomolizmi ka vazhduar të përhapet, duke përfshirë fshatrat dhe qytetet.

Kah fundi i shek. XII bogomilizmi nga Maqedonia ka filluar të përhapet, jo vetëm në shtetet ballkanike por edhe në shtetet evropiane. Në Itali bogomilët janë njohur me emrin “katarë”, në Francë “albigojcë”, në Bosnjë me emrin “patarenë” etj. Bogomilët përmenden edhe në Ligjin e Dushanit, ku janë të quajtur “babunë” dhe kundër të cilëve ishin zbatuar dënime të tmerrshme me prerjen e dorës ose këmbës. Në Ballkan, lëvizja e bogomilëve ka ekzistuar deri nën rënien e popujve ballkanikë nën sundimin osman.

Në cilat shtete është përhapur lëvizja bogomile?

SHTETI I SAMOILIT**KRYENGRITJA KUNDËR SUNDIMIT BULLGAR GJATË VITIT 969
DHE KRIJIMI I SHTETIT MAQEDONAS**

Mbreti Samoil

Në mesin e shek. X, pjesa më e madhe e Maqedonisë ka qenë në përbërje të shtetit Bullgar. Kah fundi i viteve 60-të të shek. X filloi lufta ndërmjet Bizantit dhe Bullgarisë, në të cilën si aleat i Bizantit është përzier edhe Rusia e Kievit. Gjatë luftës, vdiq mbreti bullgar Petar. Këto ngjarje i kanë shfrytëzuar djemtë e knjazit Nikolla, komitopolët (knjezët e rinj) David, Aron, Mojsej dhe Samuili për kryengritje çlirimtare në vitin 969 kundër sundimit bullgar. Kryengritja fillimisht ka përfshirë Maqedoninë Jugperëndimore. Kryengritësit kanë pasur sukses të lirojnë pjesën më të madhe të territorit dhe që në vitin 969 janë vendosur themelet e shtetit të ri sllav në Ballkan - shtetit të Maqedonisë. Qyteti i Prespës është bërë kryeqendra e shtetit maqedonas. Në krye të shtetit kanë qenë katër vëllezërit. Secili prej tyre ka udhëhequr me pjesë të territorit të shtetit. Sundimi i këtillë i të katërve është quajtur katër qeverisje (tetrarki).

TEMA 2

Në vitin 971 Bizanti pati sukses ta mundë Bullgarinë dhe ta shndërrojë në provincë bizantine. Shteti maqedonas vazhdoi së ekzistuari edhe pas vitit 971 por si shtet i varur nga Bizanti.

Në çfarë kushtesh u bë kryengritja nga ana e komitopulëve David, Aron, Mojsej dhe Samuil kundër sundimit bullgar në vitin 969?




Kalaja e Samoilit në Ohër

KRYENGRITJA KUNDËR SUNDIMIT BIZANTIN NË VITIN 976

Në vitin 976 vëllezërit David, Aron, Mojsej dhe Samuil janë ngritur kundër sundimit suprem të Bizantit dhe shteti i tyre përsëri ka qenë i pavarur dhe si i tillë ka ekzistuar deri në vitin 1018.

Menjëherë pas pavarësimit, komitopulët kanë filluar luftë për zgjerimin e shtetit. Në betejë në jug kah Kosturi, humbi jetën vëllai David, ndërkaq gjatë kohës së rrethimit të Serit humbi jetën edhe Mojseu. Me urdhër të Samoilit u vra Aroni, për shkak se me ndihmën e Bizantit ka synuar të vjedhë pushtetin e shtetit. Është vrarë edhe e gjithë familja e Aronit, ndërkaq i vetmi i gjallë ka mbetur djali i tij Aroni. Në këtë mënyrë prej vitit 976 qeverisës i vetëm i shtetit maqedonas ka ngelur Samoili, me atë që shteti është shndërruar në monarki. Si qeverisës i vetëm, Samoili pati sukses për një kohë të shkurtë të krijojë ushtri të madhe dhe të ndërtojë kuadër të madh komandues. Këmbësoria dhe kalorësia kanë qenë dy radhët themelor të ushtrisë. Në gjithë shtetin ka ndërtuar qytete të fortifikuara dhe mure mbrojtëse.

Si është bërë Samuili qeverisësi i vetëm (monark) i shtetit maqedonas?



Mbetëria maqedonase e Samuil, fundi i shek. X

ZGJERIMI I SHTETIT MAQEDONAS

Pasi që përgatiti ushtri të madhe dhe mirë të trajnuar, Samuili, filloi të zgjerojë shtetin e vet edhe në territore jo maqedonase. Në vitin 985 ka pushtuar qytetin Larisa në Thesali. Vitin e ardhshëm korri fitore në betejën tek Porta e Trajanit (Ihtinam) në Bullgari, duke i shkaktuar disfatë të madhe perandorit bizantin Vasilij II. I inkurajuar nga sukcesi, Samuili, shkoi në sulm të ri drejt Duklës dhe Dalmacisë. Në Dukla zuri peng knjazin Vladimir, ndërkaq pasi ai umartua me vajzën e Samuilut Kosara, u kthye dhe u la të drejtojë shtetin e tij. Pastaj Samuili depërtoi në Dalmaci dhe ka arritur deri në Zarë. Pastaj i ka pushtuar Bosnjën dhe Serbinë, po gjithashtu edhe një pjesë të Shqipërisë me Durrësin. Në vitin 996, në betejën me bizantin afër lumit Sperhej përjetoi disfatë të rëndë.

Deri në fund të shek. X, përpos territoreve në Maqedoni, pa Selanikun, në suazat e shtetit maqedonas kanë qenë pjesa më e madhe e Bullgarisë, një pjesë e Greqisë, një pjesë e Shqipërisë, si dhe Serbia, Bosnja dhe shtete të tjera. Pas pushtimit të këtyre territoreve Samoili në vitet e fundit të shek. X u shpall mbret në Prespë. Me këtë shteti maqedonas u shndërrua në mbretëri, e cila u quajt Maqedonase ose Mbretëria e Samuilut.

Përshkruani kufijtë e Mbretërisë Maqedonase.

TEMA 2

ORGANIZIMI I SHTETIT TË SAMOILIT

Mbretëria Maqedonase ka qenë shtet i centralizuar. Në krye të shtetit ka qëndruar monarku - mbreti, i cili ka pasur pushtet të pakufizuar. Mbreti ka jetuar në kryeqytetin Prespë, ndërsa më vonë në Ohër. Në oborrin mbretëror, ka ekzistuar zyra e oborrit, ku janë shkruar urdhra, letra, porosi etj. Për t'u udhëhequr shteti më lehtë ishte ndarë në rajone. Me rajonet kanë udhëhequr persona me prejardhje fisnike.

Rol të rëndësishëm në shtet ka luajtur kisha. Me shpalljen e Samuilit mbret, kisha Maqedonase është ngritur në kryepeshkopatë. Selia e kryepeshkopit fillimisht ka qenë në Prespë, mandej në Ohër. Për ta përfituar mbështetjen e kishës, qeverisësi i ka dhënë dhurata dhe pronë. Popullsinë e kanë përbërë aristokratë, zejtarë dhe fshatarë.

Si ka qenë i organizuar rregullimi i brendshëm i shtetit të Samuilit?



Beteja e Bellasicës

BETEJA E BELLASICËS DHE VDEKJA E SAMOILIT

Në fillim të shek. XI, mbreti bizantin Vasilij ka shpeshtuar sulmet luftarake kundër shtetit maqedonas. Me kalimin e kohës, kufijtë e Mbretërisë kanë filluar të zvogëlohen. Më 29 korrik 1014 në rrafshinën e malit Bellasicë ka ndodhur betejë e ashpër, e njohur si beteja e Bellasicës, në të cilën Samuili pësoi disfatë të rëndë, gjatë së cilës mezi ka shpëtuar duke u



Usharët maqedonas të verbuar tek mbreti Samoil

arratisur. Bizanti ka zënë robër 14-15 000 ushtarë maqedonas. Ai ka dhënë urdhër t'u nxirren sytë, ndërsa çdo ushtari të njëqindtë i ka lënë vetëm një sy. Usharët e verbuar ia ka dërguar Samuilin, i cili ndodhej në Prilep. Kur ka parë ushtrinë e verbuar, Samuili ka pësuar sulm në zemër dhe më 6 tetor 1014 ka vdekur.

Pas vdekjes fronin e Samuilin e trashëgoi djali i tij Gavrillo Radomiri. Ai nuk ka sunduar as një vit të plotë. Në vitin 1015 u vra nga kushëri i tij Vlladisllav, të cilin e kishte bindur perandori bizantin Vasili II. Menjëherë pastaj ai e ka marrë fronin mbretëror. Edhe përpos të gjitha përpjekjeve të tij, as ai nuk ka mundur të ndalojë dobësimin e shtetit. Në vitin 1018 ai u vra në betejën e Durrësit.

Pas vdekjes së tij me shtetin ka qeverisur mbretëresha Marija, bashkëshortja e Ivan Vlladisllavit. Drejtuesit e qyteteve njëri pas tjetrit i janë dorëzuar Bizantit. Në vitin 1018, mbreti Bizant ka pushtoi të gjithë Maqedoninë, me çka shteti ra nën sundimin Bizantin.

Si ka ndodhur beteja në Bellasicës dhe cilat kanë qenë pasojat e saj?

Detyrë: Të vizitohet Kalaja e Samuilin në Ohër dhe të mbahet orë mësimore nga lënda e historisë, dedikuar krijimit të shtetit maqedonas në mesjetë!

MAQEDONIA NË SHEK. XI DHE XII

POZITA E MAQEDONISË PAS RËNIES NËN SUNDIMIN BIZANTIN

Pas imponimit të pushtetit Bizantin në Maqedoni pas vitit 1018, ka vijuar një periudhë e sundimit të vështirë dhe të gjatë Bizantin. Maqedonia ka qenë e ndarë në rajone, në krye të të cilave janë vendosur nëpunës ushtarakë dhe civilë. Ata kanë kryer urdhrat e perandorit bizantin. Ata në anën e tyre kanë pasur pushtetin ushtarak dhe civil, me çka kanë mundur me sukses t'i mbledhin tatimet nga banorët e shtetit bizantin, dhe gjithashtu i kanë mbajtur të nënshtruar.

Kah mesi i shek. XI në Maqedoni filloi të rritet numri i feudalëve të mëdhenj maqedonas dhe të huaj, të cilët kanë disponuar me një numër të madh pronash në të cilat kanë punuar njerëz të varur (paric, kliricë etj.). Me prona të mëdha dhe privilegje ka disponuar edhe Peshkopata e Ohrit, e cila pas vitit 1037 është drejtuar nga ana e peshkopëve grekë.

Si fshatarët e varur ashtu edhe ata të lirë dhe qytetarët janë ngarkuar me tatime dhe detyrime të mëdha. Banorët të cilët nuk kanë mundur të sigurojnë paratë e nevojshme për të paguar tatimet ndaj shtetit, organet tatimore shtetërore ua kanë marrë fëmijët robër. Një pjesë e tatimeve për shtetin janë paguar me prodhime dhe mallra. Gjithashtu, të vështira kanë qenë edhe detyrimet e ndryshme (angari), për shkak se popullata ka qenë e obliguar pa pagesë të ndërtojë dhe të rikonstruktojë fortesa, ura, rrugë etj.

Si ka qenë gjendja në Maqedoni pas shkatërrimit të shtetit maqedonas në kohën e mesjetës?

KRYENGRITJA E PETAR DELJANIT

Gjithë kjo dukshëm ka përkeqësuar gjendjen e popullatës. Ky ka qenë shkak që të rritet rezistenca e popullit maqedonas kundër sundimit bizantin, e cila kah mesi i shek. XI u shpreh përmes organizimit të kryengritjeve të mëdha për çlirim.

Në vitin 1040 është ngritur kryengritje çlirimtare në krye me Petar Deljanin, i cili ka qenë djali i Gavrillo Radomirit, nga gruaja e tij, vajza e mbretit hungarez. Sapo kishte filluar kryengritja, përfaqësues të popullit maqedonas kanë shkuar në kufirin bizantino-hungarez për



Shpallja e Petar Dejanit për mbret



Pse u vra Tihomiri?

ta pritur Petar Deljanin. Pas shpalljes për mbret, ai u largua në Shkup. Kryengritësve maqedonas u janë bashkangjitur edhe një numër i madh i kryengritësve nga shtetet fqinje - Bullgaria, Serbia, Shqipëria, si dhe një numër i madh i popullatës greke. Për popullatën e nënshtruar të këtyre shteteve, kryengritja përpos që ka pasur karakter antifeudal gjithashtu ka pasur edhe karakterin çlirimtar.

Në vitin 1040 edhe në rajonin e Durrësit është ngritur kryengritje kundër sundimit bizantin në krye me ushtarin e guximshëm Tihomir. Në këtë mënyrë janë krijuar dy qendra kryengritëse. Së shpejti afër Dibrës janë takuar Petar Deljani dhe Tihomiri për t'u marrë vesh në lidhje me zgjedhjen e udhëheqësit të vetëm të kryengritjes.

Pas vrasjes së Tihomirit, Petar Deljani ka ngelur udhëheqësi i vetëm i të gjithë kryengritësve. Veprimet e suksesshme të kryengritësve kanë rezultuar me lirimin e pothuajse të gjithë territorit të Maqedonisë, si dhe territoret

në veri, prej Danubit deri në Atikë në jug, dhe prej Durrësit deri në Selanik.

Derisa Petar Deljani ndodhej në Ostrovo, atë e ka vizituar Alusijani, djali i mbretit të fundit maqedonas Ivan Vlladislavit. Për të mos ardhur deri te përçarje në mesin e kryengritësve Petar Deljani i ka dhënë një pjesë të ushtrisë për ta sulmuar dhe për ta pushtuar Selanikun. Por për shkak të taktikës së gabuar, pësoi disfatë të rëndë. Pas kthimit në Ostrovo ai e ka verbuar Petar Deljanin dhe menjëherë i është dorëzuar perandorit bizantin. Deljani i verbër ka qenë i pafuqishëm t'i kundërvihet Bizantinëve. Ushtritë kryengritëse në mungesë të prijësit të tyre tërësisht u shpartalluan në Ostrovo në verën e vitit 1041. Shumë shpejt Petar Deljani u zu rob dhe u dërgua në Stamboll. Me këtë kryengritja e popullit maqedonas u shua me gjak.

Pse u vra Tihomiri?

TEMA 2



Arritja e Alusijanit tek Petar Deljani

KRYENGRITJA E GEORGI VOJTEH

Pas shuarjes të kryengritjes së Petar Deljanit, Bizanti i ngarkoi maqedonasit me tatime të reja. Ky ka qenë shkak që populli maqedonas të ngrihet në kryengritje në vitin 1072, në krye me parinë shkupjane, të udhëhequr nga Georgi Votjeh. Qyteti i Shkupit u bë qendër e kryengritjes.

Pas fillimit të kryengritjes, kryengritësit kanë kërkuar ndihmën e Duklës, për shkak se sunduesi i atëhershëm Mihajlo me gjak ka qenë i lidhur me fisin e mbretit Samuil. Prandaj ai ka dërguar 300 ushtarë në ndihmë të kryengritësve maqedonas së bashku me djalin e tij Konstantin Bodin dhe vojvodën Petrillo. Kryengritësit së bashku me Georgi Vojtehun e kanë pritur Bodinin në Prizren dhe e kanë shpallur për mbret të tyre, i cili u pagëzua me emrin prej Konstantin në Petar, për nder të Petar Deljanit. Pastaj ushtria kryengritëse është drejtuar në tre drejtime për t'i çliruar edhe rajonet tjera të Maqedonisë në çka ka pasur edhe sukses. Së shpejti është çliruar e gjithë Maqedonia.



Kryengritja e Georgoi Vojteh

Mirëpo, ushtria bizantine shpejt arriti t'i shpërndajë kryengritësit në vendet Kostur, Fushë Kosovë dhe Shkup. Udhëheqësit e kryengritjes u burgosën dhe u dërguan në Stamboll. Gjatë rrugës Georgi Vojteh vdiq, ndërsa Bodini u dërgua në Stamboll, ku më vonë me ndihmën e babit të tij u kthye në Dukla. Kështu, pas një viti jo të plotë lufte edhe kjo kryengritje në fillim të viti 1073 u ngulfat me gjak, ndërsa Maqedonia përsëri ra nën pushtetin bizantin. Atëherë u shkatërrua edhe oborri mbretëror i Samuilin në Prespë, ndërsa u vodh edhe tempulli i Shën Ahilit.

Pse konstantin Bodini u shpall mbret i kryengritësve e jo udhëheqësi i kryengritësve Georgi Vojteh?

MAQEDONIA NË SHEK. XIII DHE XIV

Deri në shek. XII, Bizanti sundoi pothuajse me të gjithë popujt e Ballkanit, duke përfshirë edhe Maqedoninë? Mirëpo, kah fundi i shek. XII Bizanti filloi si ushtarakisht ashtu edhe ekonomikisht të dobësohet. Dobësinë e Bizantit e shfrytëzuan Serbia dhe Bullgaria, të cilat patën sukses të shkëlqen nga Bizanti, për të jetuar jetë të pavarur. Edhe në Maqedoni disa feudale të mëdhenj nuk kanë dashur t'i nënshtrohen perandorit bizantin edhe më tej dhe kanë bërë përpjekje të krijojnë shtet të pavarur.



Pjesët e mbetura nga kalaja mesjetare Kullat e Mbretit në Strumicë

DOBROMIR HËRS

Përpjekje të këtyllë të parë në Maqedoni për dëbimin e pushtetit bizantin ka bërë feudali Dobromir Hërs në vitin 1185. Në fillim kryeqendra e tij ka qenë në Strumicë. Pas pavarësimit, me ushtrinë e tij Hërs ka marrë kështjellën e braktisur Prosek, (në Demir Kapi), të cilën e ka shndërruar në kryeqytetin e principatës së tij. Perandori bizantin Aleksej III Angel (1195 - 1203) me ushtri të madhe është nisur drejt tij. Prej kur Hërsi i guximshëm korri fitore kundër Bizantit, perandori bizantin për ta përfituar filloi të bëjë negociata me të. Me marrëveshjen e lidhur, Hërs u njoh si sundues i pavarur i Prosekut, Strumicës dhe rajoneve fqinje të Maqedonisë. Marrëveshja është vërtetuar edhe me atë se Hërs u martua me njëren prej princeshave bizantine.

Duke i shfrytëzuar trazirat në Bizant, Hërs vazhdoi me pushtimin e shteteve të reja në Maqedoninë Perëndimore, duke pushtuar Pellagoninë me Prilepin dhe Manastirin. Por pas disa vitesh, perandori bizantin, është nisur në sulm kundër Hërsit, duke e pushtuar përsëri Pellagoninë. Në vitin 1202 perandori bizantin ka pushtuar Strumicën, ndërsa pjesën tjetër të territorit të Hërsit e pushtuan bullgarët. Kështu, Dobromir Hërs i ka humbur pothuajse të gjitha vendet të cilat i sundonte dhe ka qëndruar në Prosek, ku i humbet gjurma, me çka ka pushuar ekzistimi i sundimit të tij të pavarur.

Në cilat rajone u bë i pavarur Dobromir Hërsi?

DOBROMIR STREZ

Paraqitja e Dobromir Strezit është lidhur me ngjarjet e bujshme të cilat kanë ndodhur në Bizant dhe Bullgari. Respektivisht, gjatë asaj kohe Stambolli u pushtua nga kryqëzuesit në luftën IV të kryqëzatave, ndërsa në Bullgari janë zhvilluar luftëra të ashpra pas vdekjes së mbretit Kalojan. Duke i shfrytëzuar këto ngjarje, me ndihmën e mbretit serb Stevan Prvovençani, në vitin 1207, Dobromir Strez u pavarësua me qendër në Prosek. Nga Proseku, Strez principatën e tij me sukses e ka zgjeruar në pjesën e mesme dhe të sipërme të lumit Vardar, pastaj e ka zgjeruar sundimin në jug të Selanikut dhe në perëndim deri në Ohër. Ka luftuar me serbët, bullgarët, me despotin e Epirit dhe me Mbretërinë e Selanikut. Në vitin 1214 knezi Strez është nisur në luftë kundër Serbisë. Gjatë kohës së negociatave në mënyrë mizore u vra nga Serbët.



Vdekja e Strezit, freskë

Pas vdekjes së Strezit, Maqedonia u nda ndërmjet Latinëve, Despotisë së Epirit dhe Bullgarisë, por me rimëkëmbjen e Perandorisë Bizantine në vitin 1261, Maqedonia përsëri u gjend nën sundimin bizantin.

Si është pavarësuar feudali Dobromir Strez?

ALEKSIJ SLLAV

Në fillim të shek. XIII në Maqedoninë Lindore, në rrjedhën e mesme të lumit Struma feudali maqedonas Aleksij Sllav krijoi principatën e pavarur dhe autonome. Qendra e principatës së tij ndodhej në qytetin Melnik. Ai më së shumti ka luftuar me Bullgarët. Për t'u mbrojtur prej tyre, ka lidhur pakt me Mbretërinë Latine dhe është martuar me vajzën e mbretit latin. Pas vdekjes së mbretit latin, është bashkuar me sunduesin epirot Teodor I. Në vitin 1230, Aleksej Sllav, ka pranuar sundimin e mbretit bullgar dhe me rajonin e Strumicës ka vazhduar të sundojë deri në vdekjen e tij.

Në cilat territore ndodhej principata e Aleksej Sllavit?

SUNDIMI I PUSHTUESVE FEUDALË NË MAQEDONI GJATË SEHKULLIT XIV



Despoti Jovan Uglasha

Nga fundi i shek. XIII sundimi bizantin në Maqedoni gjithnjë e më tepër është shtypur nga sundimi i pushtuesve serbë - Nemanjiqët. Luftërat sunduese të serbëve drejt Maqedonisë i filloi mbreti Milutin, ndërsa perandori Dushan pati sukses të pushtojë gjithë Maqedoninë me përjashtim të Selanikut.

Pas vdekjes së perandorit Dushan, në territorin e Maqedonisë, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV janë krijuar tre shtete të pavarura: shteti i Serës Mbretëria e Prilepit dhe shteti i Jovan dhe Konstantin Dragashit.

Në vitin 1365, Vollkashini u shpall mbret i Mbretërisë Prilepase maqedonase, qendra e së cilës ndodhej në qytetin e Prilepit. Në kufijtë e tij janë përfshirë edhe Manastiri, Prespa, Ohri, Shkupi, Prizreni dhe qytete dhe rajone të tjera.

Rajoni i Serës, i despotit Jovan Uglasha gjithashtu përfshinte një territor të madh. Përpos Serezit dhe

TEMA 2

rrethinës, në suazat e saj ishin përfshirë edhe rajoni i Strumicës, rajonet Mellnicka dhe Dramska të Maqedonisë Lindore, rrjedhën e poshtme të Vardarit, si dhe gadishulli Hallkidiki me Sveta Gorën.

Sundues i fuqishëm feudal ka qenë edhe despoti Jovan Oliver, i cili pas vdekjes së Dushanit, kohë të shkurtë ka sunduar me territorin e rrjedhës së mesme të lumit Bregallnicë. Pas vdekjes së tij me këto territore maqedonase kanë sunduar vëllezërit Konstantin dhe Jovan Dragash, shteti i të cilëve dukshëm është zgjeruar në Maqedoninë Verilindore.

Përçarja e këtillë e territorit të Maqedonisë në më shumë shtete dhe principata, si dhe mos uniteti ndërmjet sunduesve të ndryshëm, ka qenë shkak i atë që shpejti të bëhen gjuhë i turqve Osmanli.

Cilat shtete të pavarura feudale janë krijuar në territorin e Maqedonisë pas vdekjes së mbretit Dushan?



Perandori Uroshi V dhe mbreti Vollkashin



Македониа dhe shtetet fqinje në fund të shekullit XIV

RËNIA E MAQEDONISË NËN SUNDIMIN OSMAN

BETEJA E MARICËS

Sulltan Murati I Osmanliu me ardhjen në pushtet ka paraqitur pretendimet përkatësisht aspiratat e turqve-osmanë për të sunduar me Maqedoninë. Në fillim më i rrezikuar ka qenë shteti i Serit në krye me despotin Jovan Uglesha, i cili ka qenë në kufi me Perandorinë Osmane. Prandaj despoti Uglesha ka zhvilluar aktivitet të gjerë për përfitimin e aleatëve kundër Osmanëve. Bizanti, i cili gjithashtu ka qenë i rrezikuar nga Osmanët nuk ia kanë dhënë ndihmën e premtuar. Jovan Uglesha ndihmën e vetme e ka fituar nga vëllai i tij mbreti Vollkashin. Me ushtritë e bashkuara me rreth 20.000 ushtarë vëllezërit Vollkashin dhe Uglesha janë nisur drejt qendrës osmane Odrin (Adrianopol). Ata u pritën nga ushtria osmane e udhëhequr nga Lala Shahin-Pasha dhe në sulm të pa befasishëm gjatë natës më 26 shtator të vitit 1371 tek vendi i quajtur Çernomen (në bregun e lumit Marica) vjen deri te beteja historike e Maricës. Ushtritë e sundesve Maqedonas pësuan disfatë, ndërkaq mbreti Vollkashin dhe despoti Uglesha u vranë.

Përshkruaje betejën e Maricës.



Manastiri i Markos (rrethina e Shkupit)

TEMA 2

SUNDIMI I MBRETIT MARKO

Pas vrasjes së Vollkashinit dhe Uglëshës shtetet e tyre ishin të ekspozuara në sulme nga ana e sunduesve fqinj ballkanikë. Me Serezin dhe rrethinën më të gjerë ka sunduar Bizanti, ndërkaq me pjesën tjetër e cila ndodhej ndërmjet lumenjve Vardar dhe Struma, vëllezërit Dejanoviqi, shteti i të cilëve është shtrirë në Maqedoninë Veriore me seli në qytetin e Kosturit. Pas vdekjes së mbretit Vollkashin edhe Mbretëria Maqedonase e Prilepit dukshëm është zvogëluar. Mbreti Marko (1371-1395), i cili trashëgoi babanë e tij Vollkashinin, ka qenë i pafuqishëm për t'i mbrojtur kufijtë e mbretërisë së tij. Qytetin e Shkupit e ka pushtuar Vuk Brankoviqi, ndërkaq pjesë të Mbretërisë kanë robëruar vëllezërit Dejanoviqi.



*Kullat e Markos në Prilep
(rikonstruktim i A. Deroko)*

Brenda dy dekadave, gjatë kohës së sundimit të mbretit Marko në shtetin e tij ka sunduar paqja dhe mirëqenia. Ndërtohen kisha dhe manastire në afërsi të Peshkopatës së Ohrit. Në traditën popullore ka ngelur kujtimi për mbretin Marko si mbrojtës i popullit. Ai është personazhi më i kënduar në poezinë popullore maqedonase dhe në poezinë e popujve sllavë të jugut dhe ka ngelur simbol i aspiratave për çlirim.

Si ka qenë gjendja e maqedonasve pas betejës së Marikës?



Kullat e Markos në Prilep



Krali Marko (1376)

RËNIA E MAQEDONISË NËN SUNDIMIN OSMAN

Territori i ndarë maqedonas në më shumë shtete dhe principata të pavarura, si dhe mospajtimi ndërmjet sunduesve të ndryshëm, i kanë mundësuar sulltanit Murati I pa rezistencë të madhe të pushtojë më shumë qytete dhe rajone maqedonase. Fillimisht nën sundimin osman ka rënë një pjesë e madhe e territorit të shtetit Ser. Para se të sulmohet shteti i Konstantin Dejanovit, ai me vetdëshirë ka kaluar nën sundimin suprem të sulltanit turk. Si rezultat i



Manastiri Trskavec në Prilep

përhapjes së shpejtë të osmanlinjve në Maqedoninë Qendrore, ka ardhur deri te pushtimi i më shumë qyteteve, ndër të cilat kanë qenë Prilepi dhe Manastiri. Në këtë mënyrë, në vitin 1385 edhe mbreti Marko për të ruajtur mbretërinë e tij është dashur të pranojë sundimin suprem të sulltanit. Në këtë periudhë edhe Bizanti është bërë shtet vasal i shtetit Osman . Pak më parë, pavarësinë e kishte humbur edhe Mbretëria Bullgare e Tërnovës.

Para se të fillojë beteja e Kosovës në vitin 1389, territori i Maqedonisë Veriperëndimore i është ekspozuar shkatërrimit dhe vjedhjeve të mëdha nga ana e ushtrisë së madhe osmane, e cila lëvizte drejt Fushë Kosovës. Gjatë kësaj në shërbim të Osmanlinjve u është vënë sunduesi i pavarur maqedonas Konstantin Dejanov.

Pas Betejës së Kosovës, Osmanët kanë vënë nën sundim të drejtpërdrejtë qytetin e Kratovës dhe xeheroret. Së shpejti nën sundimin turk kanë rënë edhe qyteti Voden, si dhe qytete të tjera bregdetare maqedonase. Pas luftërave të gjata u pushtua edhe qyteti i Shkupit. Në këtë mënyrë sulltani i ri Bajaziti I, ka vënë nën sundimin e drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte të gjithë territorin e Maqedonisë. Sunduesit maqedonas, mbreti Marko dhe Konstantin Dejanov, i kanë qëndruar besnikë sulltanit deri në vdekjen e tyre. Si vasal turk mbreti Marko ishte i obliguar të marrë pjesë në betejat e Bajazitit të parë në Azinë e Vogël. Gjithashtu, së bashku me Konstantin Dejanovin ka marrë pjesë edhe në betejën në Rovin në vitin 1395, kundër vojvodës vllah Mirçe, në të cilën të dy kanë humbur jetën.

Pas vrasjes së Markos dhe Konstantin Dejanovit iu dha fundi edhe ekzistimit të dy shteteve të veçanta në Maqedoni. Atëherë i gjithë territori i Maqedonisë, me përjashtim të Selanikut, është vënë nën sundimin e Turqve Osmanë. Në fillim të shek. XV Osmanët e kanë pushtuar edhe qytetin e Selanikut, me çka për të gjithë popullin maqedonas ka filluar periudha e sundimit të gjatë osman.

Pse mbreti Marko dhe Konstantin Dejanov janë bërë vasal turk?

Kur ka rënë Maqedonia përfundimisht nën sundimin Osman?

NGJARJET KULTURORE NË MAQEDONI DERI NË FUND TË SHEKULLIT XIV

SHKRIMI DHE LETËRSIA

Me krijimin e Shkollës letrare të Klimentit në Ohër në gjysmën e dytë të shekullit IX, në mënyrë të shpejtë filloi të zhvillohet alfabeti dhe letërsia maqedonase. Numri i madh i njerëzve të arsimuar të cilët kanë dalë nga shkolla e Klimentit kanë vazhduar të përdorin alfabetin glagolik, të cilin e përpiluan vëllezërit e shenjtë Kirili dhe Metodi. Në gjysmën e dytë të shekullit X edhe pse në shtetin e ri të sapoformuar maqedonas, kirilica është bërë alfabeti zyrtar i shtetit, megjithatë deri në shek XII glagolica ka qenë alfabeti dominues në Maqedoni.

Pas rënies së Mbretërisë së Samuilin në vitin 1018, ka vazhduar të zhvillohet kultura sllave maqedonase. Qendrat kryesore arsimore kanë qenë kishat e manastireve Shën Gavrill Lesnovski, Shën Joakim Osovski, Shën Prohor Pçinski etj. Të gjitha këto kanë pasur lidhje të ngushta kulturore me manastiret në Sveta Gora. Gjatë shekullit XI dhe XII janë shkruar vepra letrare me alfabetin glagolik dhe cirilik. Prej veprave letrare glagolike më të rëndësishme janë: e Asemanit, Zografit, Ohrit dhe ungjij të jerë, ndërsa cirilike më të rëndësishme janë: Triodi i Manastirit, ungjilli i Dobromirit, peshkopit të Ohrit etj.

Vepra letrare të rëndësishme janë krijuar edhe gjatë shekujve XIII dhe XIV. Gjatë kësaj periudhe me dominim ka qenë alfabeti cirilik. Vepra letrare më të rëndësishme të kësaj periudhe janë: ungjilli i Dobrejshevës dhe Radomirit, minej i Strumicës dhe i Shkupit etj. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar edhe qendrat letrare të manastireve në Shkup, Prilep, Ohër, Dibër, Strumicë, Kostur, si dhe në vise të tjera të Maqedonisë.

Gjatë shekullit XIV janë krijuar edhe më shumë romane historike legjendare. Prej tyre më të njohur janë romanet Aleksandri i Maqedonisë, në të cilin bëhet fjalë për betejat e mëdha sunduese të Lekës III të Maqedonisë, pastaj romani Troja, në të cilin është theksuar legjenda për luftën e Trojës etj.



Ungjilli i Asemanit në gllagolicë, fundi i shek. X fillimi i shek. XI

*Cilat qendra letrare më të rëndësishme janë krijuar në Maqedoni në shek. XI - XIV?
Trego disa vepra letrare të shkruara në alfabetin glagolik dhe cirilik.*



Kisha shën Sofija në Ohër

ARKITEKTURA DHE ARTI

Në hapësirat e Maqedonisë janë ruajtur shumë mbetje të qyteteve të atëhershme të fortifikuara: Kullat e Markos në Prilep, Kalaja e Shkupit etj. Të rrethuara me mure të larta të fortifikuara ato kanë shërbyer për mbrojtje nga armiqtë e jashtëm.

Gjatë shekullit IX dhe X në territorin e Maqedonisë janë ndërtuar më shumë kisha prej të cilave më të rëndësishme janë: ajo e Klimentit, Naumit dhe Shën Sofija në Ohër, Shën Pantelejmoni në Nerez (Shkup), Shën Ahili në ishullin Ahil në Prespën e Vogël, Shën Leontij dhe Shën Mërija Eleusa në Strumicë etj. Të gjitha këto janë ndërtuar nën ndikimin e kulturës bizantine.

Me zhvillimin e kulturës njëkohësisht është zhvilluar edhe pikturimi i afreskeve. Një rëndësi të lartë artistike kanë afresket në Shën Sofija në Ohër, Shën Mërija Eleusa, Shën Pantelejmoni etj. Nga sfera e pikturimit të afreskeve më të njohur janë zografët e fundit të shekullit XIII dhe fillimit të shekullit XIV Mihami dhe Evtihij.

Progres të madh ka arritur edhe ikonografia. Kishat maqedonase kanë qenë të mbushura me ikona të shumta në të cilat kanë qenë të pikturuara fytyrat e Krishtit, shenjtorë etj. Nga periudha më e hershme veçanërisht vlerësohen ikonat e kalasë së Vinicës, ndërsa nga ato më

TEMA 2

të vjetrat ato të cilat janë krijuar në qendrat e artit në Ohër, Strumicë dhe vende të tjera. Të gjitha këto qendra së bashku kanë prezantuar shkollën artistike maqedonase.

*Manastiri Shën Pantelejmoni, Shkup
Cilat janë kishat më të njohura dhe manastiret e kësaj periudhe?*



Manastiri Shën Pantelejmoni, Shkup

MUZIKA

Në Maqedoni në periudhën mesjetare në mënyrë të shpejtë filloi të zhvillohet edhe arti i muzikës. Muzika maqedonase është zhvilluar nën ndikim të fuqishëm të muzikës bizantine dhe kryesisht ka pasur karakter kishtar. Pas krijimit të shtetit maqedonas ka filluar të zhvillohet edhe muzika jokishtare. Ushtria e Samuilut ka pasur instrumente muzikore: truba, trumbeta etj.

Krijuesit muzikor maqedonas kanë pasur meritë të madhe edhe për zhvillimin e kulturën muzikore të përgjithshme bizantine. Kompozitori kishtar më i spikatur dhe pedagog muzikor me prejardhje maqedonase në shek. XIV është Jovan Kukuzel, nga f. Xhermenci (Dibër). Ai është arsimuar në Stamboll, ndërkaq më vonë është larguar në Sveta Gora dhe atje ka krijuar shkollën e tij për muzikë dhe këndim. Ai konsiderohet si themelues i alfabetit të ri të notave në kishën ortodokse Lindore, d.m.th., reformues i muzikës bizantine. Në krijimtarinë e tij muzikore ai ka inkorporuar edhe mjaft elemente të muzikës popullore maqedonase.

Çfarë rëndësie ka pasur Jovan Kukuzel për krijimtarinë muzikore të asaj periudhe?



Jovan Kukuzel

TEMA 3.
MAQEDONIA NËN PUSHTETIN OSMAN
(DERI NË MES TË SHEK XIX)



NDRYSHIMET SHOQËRORE - EKONOMIKE DHE KULTURORE

THEMELIMI I SISTEMIT TIMARO-SPAHIK

Perandoria Osmane ka qenë e organizuar si shtet ushtarak - feudal në krye me sulltanin. Pushteti i sulltanit ka qenë i pakufizuar. Ai ka pasur pushtet absolut politik dhe fetar, i cili ka mbrojtur interesat e feudalëve turq. Për sundim më të mirë dhe më efikas, Perandoria ka qenë e ndarë në qarqe ushtarake të ashtuquajtura sanxhaqe. Në krye të sanxhakut është emëruar sanxhakbeu. Më pas, pas zgjerimit territorial të Perandorisë Osmane, më shumë sanxhaqe kanë formuar një njësi të madhe të ashtu quajtur beglerbegluk, në krye me beglerbeun (ajalet). Pas okupimit të Azisë së Vogël edhe në territoret ballkanike Osmanët nuk i kanë likuiduar marrëdhëniet zeytare feudale, por kanë vendosur sistemin e tyre feudal të njohur si sistemi timaro-spahik.

Në shtetin Osman kanë ekzistuar disa lloje të pronës së tokës: tokë në pronë shtetërore, në pronë të familjes së sulltanit, tokë e institucioneve fetare dhe tokë në pronë private



Spahiu (majtas) dhe aga jeniçer (djathas) me jeniçerë

Nga radhët e aristokracisë turke në feudalizmin e herët është formuar shtresa e feudalëve ushtarakë të quajtur spahi. Ata, si dhuratë prej sulltanit, kanë marrë toka të a.q. leno - spahillëk - me kusht të marrin pjesë në luftë si kalorës. Tokat të cilat i kanë marrë spahinjtë nuk ka qenë në pronë të tyre private. Spahinjtë kanë mundur edhe të humbin lehtë spahillëkun nëse nuk i plotësojnë obligimet ushtarake. Feudalët të krishterë lokal me ardhjen e Osmanëve, për të mos i humbur pronat, kanë pranuar islamit dhe kanë qenë të njohur si spahi - të krishterë.

Të tjerët, të cilët i kanë mbetur besnik fesë së tyre ortodokse, kanë humbur pronat ose janë larguar në vende të huaja.

Pse sistemi turk feudal është quajtur timaro-spahik?

EKSPLOATIMI EKONOMIK I RAJËS DHE SISTEMI TATIMOR

Fshatarët kanë pasur detyrime të mëdha ndaj shtetit osman edhe ndaj feudalëve. Detyrimet ndaj feudalëve janë shprehur në formë të rentës. Ka pasur tre lloje të rentës: në natyrë, me punë, dhe me para. Në feudalizmin e hershëm ka dominuar kryesisht renta në natyrë. Ajo është përfshirë në të dhjetat (ushur). Me rentën e punës fshatari disa ditë gjatë vitit është dashur të punojë në pronën e feudalit.

Gjatë periudhës së feudalizmit më të zhvilluar, me paraqitjen e marrëdhënieve të mallrave dhe parave, sunduesit kanë kërkuar renta të paguhet me para. Fshatarët gjithashtu kanë pasur për detyrë të paguajnë detyrimet ndaj shtetit, siç janë: haraç, tatim për kafshët, tatimin e luftës etj. Më i vështirë ka qenë “tatimi me gjak” (devshirme). Të krishterët kanë qenë të obliguar të japin fëmijë të vegjël dhe të shëndetshëm për të plotësuar ushtrinë e jeniçerëve.

Cilat tatime i kanë paguar fshatarët?

KOLONIZIMI

Pas pushtimit Osman në Maqedoni, ka filluar procesi i kolonizimit të brendshëm (tërheqja e popullatës maqedonase nga fushat në male), por edhe procese të kolonizimit osman (Konjarë, Jurukë) nëpër fshatrat dhe qytetet. Kolonizatorët me vete kanë sjellë edhe zakonet e tyre, traditat dhe shprehjet ekonomike. Qytetet gjithnjë e më tepër kanë fituar karakterin osman. Faktor më i rëndësishëm i kolonizimit osman kanë qenë blegtorët turq - Jurukët. Ata kanë banuar në Azinë e Vogël në pjesë të pa populluara. Si rezultat i kësaj janë krijuar më shumë vendbanime të jurukëve.

Përpos proceseve të migrimit të popullatës maqedonase, është zhvilluar edhe emigracioni i popullatës jo maqedonase në territorin e Maqedonisë. Nga Spanja kanë migruar popullata hebraike, veçanërisht në Selanik, e cila me aktivitetin ekonomik ka kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të qytetit. Në shekullin XVIII në pjesën perëndimore të Maqedonisë gradualisht nga Shqipëria është shpërngulur populli shqiptar. Gjithashtu edhe një numër i madh i vllahëve kanë populluar qytetet e Maqedonisë.

Pse osmanët kanë bërë kolonizim në Maqedoni?

TEMA 3

ISLAMIZIMI

Që nga fillimi i robërisë turke, populli maqedonas është dashur në mënyrë të shkathhtë të mbrohet nga islamizimi. Në islam fillimisht është konvertuar një pjesë e feudalëve të vjetër,



Xhamia e larme në Tetovë

me qëllim që t'i ruajnë tokat e tyre dhe privilegjet. Islamizimi gradualisht ka marrë përmasa më të gjera. Nga islamizimi më masovik më të cenuar kanë qenë pjesët e Maqedonisë perëndimore dhe lindore, respektivisht luginat e lumenjve Drin dhe Radika, dhe rrafshnalta e Despotit dhe mali Pirin. Popullata krishtere e këtyre trojeve ka pranuar islamin edhe për t'u ikur detyrimeve të mëdha dhe zullumeve edhe përkundër islamizimit me forcë. Maqedonasit e islamizuar (torbeshë ose pomakë) e kanë ruajtur gjuhën e tyre dhe shumë tradita popullore dhe fetare. Ata paraqesin pjesë përbërëse të popullit maqedonas.

Cilat kanë qenë shkaqet që një pjesë e maqedonasve të pranojnë islamin?



Pjesa e brendshme e xhamisë



Xhamia Mustafë Pashës në Shkup

REZISTENCA KUNDËR SUNDIMIT OSMAN

SHKAQET PËR REZISTENCË

Pozita e popullatës krishtere në Perandorinë Osmane vazhdimisht është përkeqësuar. Fshatarët ishin të varur dhe të detyruar të punojnë në tokat e feudalëve, të punojnë argatë (punë të pa paguar) për nevojat e shtetit ose të feudalëve, të cilët sipas rregullit kanë qenë myslimanë. Përpos kësaj, ata kanë pasur detyrime të mëdha tatimore edhe ndaj shtetit edhe ndaj feudalëve. Zullumet dhe terrori kanë qenë dukuri e përditshme. Shpesh u është prekur edhe nderi dhe dinjiteti i njerëzve, janë vjedhur vajza dhe gra, janë marrë fëmijë të krishterë, për nevojat e ushtrisë osmane, është bërë presion për pranimin e islamit etj. E gjithë kjo ka shkaktuar pakënaqësi të madhe dhe rezistencë te popullata krishtere.

Cilat kanë qenë shkaqet për rezistencën e popullatës në periudhën e sundimit osman?

LLOJE TË REZISTENCËS



Shën Zllata Maglenska

Që në shekujt e parë të sundimit osman ka ardhur deri te rezistenca e përforcuar nga ana e popujve krishterëve të nënshtuar, kundër sundimit osman. Është shfaqur nëpërmjet rezistencës pasive (të pa armatosur) dhe rezistencës së armatosur.

Rezistenca pasive është manifestuar në mënyra të ndryshme. Fshatarët e ngarkuar me detyrime të ndryshme dhe angari kanë filluar në mënyrë masive të lëshojnë fshatrat dhe të fshihen në vendet malore të paarritshme dhe në rajonet e minierave. Në atë mënyrë fshatarët i janë shmangur pagesës së tatimeve nga ana e organeve tatimore shtetërore dhe pronarëve feudalë. Rezistencë të pa armatosur popullata krishtere ka dhënë gjatë kohës së marrjes së fëmijëve nga ana e jeniçerëve. Atëherë prindërit i kanë fshehur fëmijët e tyre, për t'i mbrojtur, ata i kanë martuar në moshën 8 -9 vjeç, i kanë gjymtuar, u kanë vizatuar kryqe në ballë etj. Maqedonasit të cilët kanë kundërshtuar të pranojnë fenë islame, janë vrarë.

TEMA 3

I tillë është rasti me Zllata Meglenska dhe Gjorgji Kratovskin. Ata si martirë të krishterë, nga ana e kishës janë shpallur për shenjtorë.

Lloji më i vjetër dhe më i përhapur i rezistencës së armatosur ishte hajdutëtëria (komitët). Hajdutët kanë qenë të organizuar në banda, të përbëra prej 20-30 personash. Në krye të çdo bande ka qenë harambashi ose vojvoda. Bandat janë mbledhur rreth Shën Gjergjit (në pranverë), dhe janë shpërbërë rreth Shën Mitrit (në vjeshtë). Gjatë dimrit janë strehuar te mbrojtësit e tyre jatakët. Hajdutët më shpesh i kanë sulmuar pronat e feudalëve, spahinjve, grumbulluesit e tatimeve, karvanët turq etj. Rezistenca e hajdutëve është kënduar në shumë këngë popullore maqedonase.



Hajdutë të Ohrit

Cilët hajdutë janë përshkruar në këngët popullore maqedonase?

KRYENGRITJA E MARIOVËS - PRILEPIT

Lloj më i lartë i rezistencës së armatosur kanë qenë kryengritjet. Ato fillimisht janë paraqitur në zonat malore dhe vështirë të arritshme. Kryengritja e parë në Maqedoni ka qenë ajo e Mariovës - Prilepit (1564-1565). Për shkak të tatimeve të rënda dhe egoizmit të sunduesve turq, rreth 1000 fshatarë të rajonit të Mariovës - Prilepit, të armatosur me shkopinj, sëpata dhe sfurqe, e kanë sulmuar gjykatën në Prilep. Kryengritja nuk ka qenë mjaft e organizuar dhe shpejt është shuar.

Në shekullin XVII kryengritjet janë shpeshtuar, ndërsa shoqëritë e hajdutëve janë rritur në numër. Kjo dukuri ka paralajmëruar kryengritjet e llojit më të lartë të rezistencës.

Çfarë domethënie ka kryengritja e Mariovës - Prilepit?

KRYENGRITJA E SKËNDERBEUT

Turqit - Osmanë që në vitet e 80-ta të shekullit XIV kanë hyrë në territorin shqiptar. Deri në fillim të shekullit XV Osmanët e kanë imponuar pushtetin e tyre në pjesën më të madhe në territorin e Shqipërisë. Feudalët shqiptarë të familjeve Topia, Kastriotë, Arianitë, Dukagjin etj., janë bërë të varur nga sulltani turk dhe kanë vazhduar të sundojnë në vilajetet

e tyre. Në gjysmën e parë të shekullit XV një pjesë e territorit shqiptar është vënë nën sundim të drejtpërdrejtë të pushtetit osman.

Në atë periudhë një nga feudalët e mëdhenj shqiptarë dhe vasal i turqve ka kenë Xhon Kastrioti, vilajetet e të cilit ndodheshin ndërmjet lumenjve Mati dhe Drini. Djali i tij më i vogël Gjergj Kastriot-Skënderbeu (1405-1468), i është dhënë peng sulltan Muratit II. Qysh si fëmijë ai është dalluar si ushtar i guximshëm dhe udhëheqës i ushtrisë në betejat të cilat i kanë zhvilluar Osmanët. Për shkak se kishte pranuar fenë islame ai ka filluar të marrë funksione të larta shtetërore. Për nder të fitoreve të tij kundër armiqve të Turqisë është quajtur Skënder sipas emrit të Lekës së Madh dhe është bërë i njohur me emrin Skënderbeu.

Gjergj Kastrioti nuk i ka qëndruar besnik sulltanit. Duke e shfrytëzuar progresin e kryqëzatave, në vitin 1443 ka ngritur kryengritje në Shqipëri kundër sundimit turk. Gjatë kësaj ka tërhequr pjesë të madhe të ushtarëve dhe numër të madh të popullatës nga fshatrat dhe qytetet. Përpos popullit shqiptar në kryengritje kanë marrë pjesë edhe maqedonasit dhe vllahët. Ushtria kryengritëse pas çlirimit të qytetit të Krujës ka çliruar të gjithë territorin shqiptar nga Vjosa deri në Arta. Më datë 28 nëntor të vitit 1443 Skënderbeu u shpall administrator i Principatës së Kastriotëve. Prej atëherë në esencë daton edhe flamuri i fisit Kastriot, i cili paraqet shqiponjën me dy kokë në bazament të kuq. Më vonë ky është bërë edhe flamur kombëtar. Kryengritja është zgjeruar edhe në territorin kufitar maqedonas, duke përfshirë rajonin e Dibrës. Më shumë se 20 vjet Skënderbeu me sukses u është kundërvënë Turqve Osman. Pas vdekjes së Skënderbeut, rezistenca e shqiptarëve zgjati edhe disa vite. Me rënien e qytetit të Krujës nën sundimin turk në vitin 1478, kryengritësit janë mposhtur, ndërsa territori i Shqipërisë është vënë në suazat e Perandorisë Osmane.

Cila është rëndësia e Skënderbeut në luftën e popullit shqiptar kundër Osmanëve?



Skënderbeu



Përkrenarja e Skënderbeut

KRYENGRITJA E KARPOSHIT

Në mesin e vitit 1689 ushtria austriake ka hyrë në territorin e Serbisë, në Maqedoni bandat më të vogla të hajdutëve janë organizuar në çeta më të mëdha. Populli maqedonas ushtrinë austriake e ka parë si mik dhe ka shpresuar se me ndihmën e saj do të fitojë lirinë. Në rrethinën e Kriva Pallankës udhëheqësi më i dalluar hajdut ka qenë Karposhi. Kur ka dëgjuar për ardhjen e ushtrisë austriake, në afërsi të Maqedonisë, ka bashkuar hajdutët.

Në mesin e tetorit të vitit 1689 në Maqedoninë veriore në rajonin ndërmjet Shkupit dhe Qystendillit është ngritur kryengritje e madhe çlirimtare. Në krye të çetave hajdute, të cilëve u janë bashkangjitur shumë banorë të fshatrave dhe qyteteve, ka qëndruar cubi i shquar Karposhi. Kryengritësit e kanë çliruar Maqedoninë Veriore, me qytetet Kriva Pallankën, Kratovën, Kumanovën dhe Shkupin. Mbreti austriak Leopold, kur ka dëgjuar për kryengritjen, ka shpallur Karposhin për “mbret të Kumanovës”. Në Shkup atëherë ka arritur ushtria austriake, në krye me Pikolominin. Për shkak se në qytet ka sunduar epidemia e kolerës, ai ka urdhëruar të digjet i gjithë qyteti pas çka është tërhequr nga Shkupi. Pjesë tjera të ushtrisë austriake kanë arritur deri në Veles dhe Shtip.

Në ndërkohë ka ardhur deri në kthesë të gjendjes luftarake në Ballkan. Për shkak të angazhimit në luftën me Francën, ushtria austriake ka filluar të tërhiqet në veri. Turqit - Osman nën komandë të Mustafa pashës Quprili kanë kaluar në ofanzivë. Në Kumanovë është zhvilluar beteja vendimtare, në të cilën kryengritësit kanë pësuar disfatë. Udhëheqësi i kryengritjes Karposhi u zu rob dhe u çua në Shkup, ku u vra në mënyrë mizore. U ngul në hu, pastaj u var dhe u shpua me shigjetë, u copëtua u hodh në Vardar. Vdekja e tij tragjike ka shënuar fundin e kryengritjes.

Përshkruani vijimin e kryengritjes së Karposhit.



Pamja e Shkupit Gravurë e shek. XVII

KRYEPESHKOPATA E OHRIT

FILLIMET E ORGANIZIMIT KISHTAR NË MAQEDONI

Kisha maqedonase ka rrënjët nga periudha e hershme krishtere. Apostulli Pal me komunat e para krishtere në Maqedoni ka vendosur themelet e kishës maqedonase. Shën Klimenti, si “peshkop i parë sllav” i cili ka qenë në rolin e përhapësit të krishterimit dhe gjuhës sllave në mesin e Sllavëve të Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Me krijimin e shtetit mesjetar maqedonas, u krijua kisha e pavarur - peshkopata. Selia e saj fillimisht ka qenë në Prespë, më vonë është transferuar në Ohër. Peshkopi i parë i kishës maqedonase ka qenë Germani. Sipas qytetit të Ohrit, ku më gjatë ka qëndruar selia e Peshkopatës edhe është njohur si Peshkopata e Ohrit. Pavarësinë e saj e ka pranuar papa i Romës. Pas rënies së Mbretërisë Maqedonase, perandori Bizant Vasilij II, ka emëruar Jovan Debarskin për peshkop të ri dhe ka vërtetuar pavarësinë (autonominë) e Peshkopatës së Ohrit. Nën pushtetin kishtar të saj kanë qenë 31 dioqeza në Maqedoni, Epir, Thesali, Serbi dhe Bullgarinë Nëndanubiane. Pas vdekjes së peshkopit Jovan në vitin 1037, si peshkopë janë caktuar grekë, të cilët filluan të përhapin kulturën greke duke përjashtuar letërsinë dhe predikimin sllav, të cilin edhe më tutje vazhduan ta kultivojnë priftërinjtë nëpër manastiret.

Çfarë ndodhi me peshkopatën e Ohrit pas shkatërrimit të Mbretërisë Maqedonase?

PESHKOPATA E OHRIT GJATË KOHËS SË SUNDIMIT OSMAN

Pas rënies së Maqedonisë nën sundimin osman, Peshkopata e Ohrit ka qenë institucioni i vetëm maqedonas i cili vazhdoi veprimin e saj. Në fillim të sundimit maqedonas, Peshkopata e Ohrit ka ekzistuar si kishë e pavarur, duke mbajtur një pjesë të mirë të të drejtave të mëparshme dhe privilegjet. Me leje të pushtetit osman në suazat e Peshkopatës së Ohrit janë kyçur kishat bullgare, si dhe kishat e Vllahisë dhe Moldavisë. Gjithashtu deri në rimëkëmbjen e Peshkopatës së Pejës në mesin e shekullit XVI janë kyçur edhe pjesë të kishës Serbe, dhe njëkohësisht edhe një pjesë e kishave jugore italiane.

Pas përfitimeve të mëdha territoriale në Ballkan, Osmanët kanë filluar të ndryshojnë marrëdhënien e tyre ndaj kishës së Ohrit. Që nga shekulli XV osmanët e kanë shndërruar katedralen e Shën Sofisë në Ohër në xhami. Përpos saj në xhami janë shndërruar edhe kisha të tjera, ndër të cilat ka qenë edhe ajo e Klimentit Shën Pantelejmon. Sulltani filloi të ndryshojë marrëdhënien e tij ndaj kishës së Ohrit edhe përpos asaj se ajo gjithnjë e më tepër është paraqitur edhe si organ i lëvizjeve çlirimtare të popullit maqedonas kundër sundimit osman, duke kërkuar ndihmën e shteteve evropiane. Për të vazhduar veprimin e saj Peshkopata e Ohrit është dashur të paguajë sulltanit tatime të mëdha vjetore.

Si ka qenë pozita e Peshkopatës së Ohrit në Perandorinë Osmane?



Kisha katedrale Sh. Sofija

*Kisha Shën
Jovan Kaneo*



PESHKOPATA E OHRIT GJATË KOHËS SË SUNDIMIT OSMAN

Peshkopata e Ohrit ka mbajtur lidhje të afërta me Patrikanën e Stambollit. Patrikana, me propozim të Sinodit të Peshkopatës, si organ i saj më i lartë, i ka emëruar peshkopët e Ohrit. Ajo ka filluar të përzihet edhe në punët tjera të saj. Peshkopët e Ohrit janë angazhuar për pavarësi më të madhe të kishës dhe kanë mbështetur luftën kundër Osmanëve. Për këtë qëllim ata kanë kërkuar mbështetjen e shteteve evropiane. Shumica e peshkopëve të Ohrit, nga sunduesit e shteteve evropiane kanë kërkuar ndihmë me para për kishën dhe mbështetje në luftën kundër Osmanëve. Shumë prej tyre bile edhe kanë qenë ithtarë të unionit kishtar me kishën katolike të Romës, të vihen nën kontroll të sundimit të saj suprem nëse Evropa ndihmon të lirohet populli maqedonas nga sundimi osman. Por ndihma e këtillë ka munguar.

Cilat kanë qenë lidhjet e peshkopatës së Ohrit me shtetet evropiane?

SUPRIMIMI I KRYEPESHKOPATËS SË OHRIT

Nga shekulli XVII peshkopët e Ohrit gjithnjë e më tepër u janë ekspozuar sulmeve të Patrikanës së Stambollit, e cila është udhëhequr nga peshkopë grekë. Patrikana është angazhuar të marrë udhëheqjen ndaj Kryepeshkopatës së Ohrit dhe të emërojë personin e vet për kryepeshkop. Marrëdhëniet e ndërsjella janë përkeqësuar në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Me mbështetjen e sulltanit, Patrikana e Stambollit ka pasur sukses të marrë më shumë kisha të Kryepeshkopatës së Ohrit. Kryepeshkopi i Ohrit Arsenij, duke mos mundur të durojë presionin e Patrikanës së Stambollit, më 16 janar të vitit 1767 dha dorëheqje me shkrim. Me dorëheqjen është suprimuar Kryepeshkopata e Ohrit, ndërkaq territoret e saja i janë bashkangjitur Patrikanës së Stambollit. E gjithë kjo ka pasur pasoja të mëdha mbi popullin maqedonas. Priftërinjtë maqedonas filluan të zëvendësohen me grekë, që ka rezultuar me përhapjen e gjuhës dhe kulturës greke në Maqedoni.

Si u suprimua Kryepeshkopata e Ohrit?

DOBËSIMI I SHTETIT OSMAN

SHKATËRRIMI I SISTEMIT TIMARO-SPAHIK

Në gjysmën e dytë të shek. XVI Perandoria Osmane ka filluar të dobësohet, dhe të pësojë disfatat e para më të rënda luftarake. Kështu, flota turke ka pësuar disfatë të rëndë në betejën e Lepantos në vitin 1571 nga ana e forcave të bashkuara detare të Spanjës dhe Venedikut, si dhe disfata e ushtrisë turke në betejën e Sisakut në vitin 1593 nga ana e ushtrisë të bashkuar austriake dhe kroate. Dobësimi i shtetit kishte të bënte para së gjithash me shkatërrimin e sistemit timaro-spahik i cili u shkatërrua nën ndikimin e goditjeve të fuqishme të raportit mall-para. Tani feudalët kanë tentuar të gjitha detyrimet



Ali pasha i Janinës

t'i shndërrojnë në detyrime me para. Kjo ka ndikuar të zmadhohet eksploatimi dhe të përkeqësohet pozita e rajës. Në kërkesë të parave, pushteti qendror turk edhe vetë ka kontribuar për shkatërrimin e sistemit timaro-spahik. Spahillëqet dhe pronat tjera shtetërore, shteti më shumë nuk ua ka ndarë spahinjve për shkak të meritave luftarake, por ua ka dhënë me qira personave të cilët nuk kanë pasur asgjë me rendin spahik. Vetë e kanë përforcuar eksploatimin e rajës, për të zmadhuar tatimet. Duke i shfrytëzuar rregullat ligjore edhe raja ka filluar të shesë pronat e veta (pronë e trashëguar - bashtinë) Personat të cilët i kanë blerë këto toka të njëjtat i kanë shndërruar në prona të tyre të trashëguara - çifligje të cilat mund të ishin edhe fshatra të tëra. Pronarët e tyre janë quajtur çifli-sajbi. Pronat e tyre i kanë dhënë me qira t'i punojnë fshatarët pa toka, të cilët janë quajtur çifligarë. Marrëdhëniet e këtilla çifligare në Maqedoni veçanërisht janë krijuar në shek. XVII.

Pse dhe si ka ardhur deri te shkatërrimi i sistemit timaro-spahik dhe instalimi i sistemit të çifligjeve?

ANARKIA FEUDALE DHE NDRYSHIMET NË MAQEDONI

Kriza e sistemit timaro-spahik në shtetin osman në shek. XVIII është shndërruar në anarki feudale. Feudalë të mëdhenj individualë të pushtetit qendror nuk kanë njohur as sundimin e sulltanit, kanë disponuar me ushtrinë e tyre dhe kanë bërë politikë të jashtme të pavarur. Për zgjerimin e pronave të tyre, ata shpesh kanë bërë luftëra ndërmjet vete. Nga kjo më shumë kanë pësuar popullata e pafajshme. Njëri ndër personat e këtyllë në Maqedoni ka qenë Mahmud pashë Bushatlia, i cili është përforcuar në Shkup, Dibër dhe Ohër. Në pjesën jugperëndimore të Maqedonisë është forcuar Ali pasha i Janinës. Në rajonin e Ohrit i njohur ka qenë Xheladin Beu dhe Ismail beu. Shteti osman një kohë më të gjatë nuk ka mundur të përballet me ta.

Njëkohësisht nëpër gjithë Maqedoninë janë paraqitur dhe kanë vepruar bandat hajdute, të cilët kanë numëruar prej 400 - 500 persona të përbërë nga shqiptarë dhe turq, të cilët i kanë plaçkitur dhe terrorizuar popullatën. Pasojat e kësaj ka qenë migrimi i madh i popullatës maqedonase veçanërisht nga Maqedonia perëndimore, ndërkaq në vendin e tyre janë vendosur me banim shqiptarët. Dhunë të madhe mbi popullatën në Maqedoni kanë ushtruar edhe të ashtuquajturat bandat kërxhale. Bandat kërxhalike në Maqedoni janë paraqitur gjatë luftës Ruse-turke kah fundi i shek. XVIII. Qendra e veprimit të tyre në Maqedoni, kanë qenë Rodopet, Mali Shar, Mali i Zi i Shkupit, Dibër, Pllaçkovicë dhe Ograzhden. Bandat kërxhalike kanë numëruar edhe deri në 2000 persona, ndërkaq janë përbërë prej ushtarë - dezertorë dhe persona tjerë të religjioneve dhe kombësive të ndryshme. Ata kanë sulmuar qytete dhe fshatra, dhe në to kanë vjedhur si popullatën maqedonase por edhe atë myslimane.

Cilat kanë qenë shkaqet për paraqitjen e anarkisë feudale?

NDRYSHIMI I STRUKTURËS ETNIKE TË QYTETEVE NË MAQEDONI DHE PËRFORCIMI I POPULLSISË QYTETARE

Rrugëdalje nga varfëria e padurueshme dhe dhuna, fshatari maqedonas ka kërkuar me ikjen nga fshati dhe banimin në qendrat qytetare. Atëherë qytetet kanë ofruar siguri më të madhe dhe mundësi për përfitim më të mirë dhe jetë solide. Dyndja e madhe e popullatës maqedonase fshatare në qendrat qytetare ka ndikuar në ndryshimin e përbërjes etnike në qytetet e Maqedonisë. Qytetet maqedonase gradualisht janë maqedonizuar. Nga ana tjetër, me zmadhimin e popullatës qytetare janë krijuar kushte për zhvillim të përshpejtuar të ekonomisë qytetare, në radhë të parë të zejtarisë dhe tregtisë. Tregtia më parë ka qenë në duart e grekëve, hebrenjve etj., por me zmadhimin e popullatës maqedonase gradualisht ka kaluar në duart e tregtarëve maqedonas.

Çfarë ndryshimesh janë paraqitur në qytetet e Maqedonisë?

TEMA 3


KRYENGRITJA E NEGUSHIT

Lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve të Ballkanit në fillim të shek. XIX kanë hasur në reflektim pozitiv në pjesën jugore të Maqedonisë përmes kryengritjes së Negushit. Ndikim të fuqishëm mbi disponimin për kryengritje në këtë pjesë të Maqedonisë ka pasur Ali pasha i Janinës dhe ndikimi i kryengritjes greke (1821).

Kryengritja filloi në mars të vitit 1822, me sulmimin e qytetit Negush. Në të kanë marrë pjesë maqedonas, vllahë dhe grekë. Udhëheqës të kryengritjes kanë qenë Anastas Karatasho, Angel Gaco dhe Zafirakis. Kryengritësit kanë pasur sukses të mundin garnizonin turk dhe e kanë marrë qytetin, pastaj kryengritja është zgjeruar drejt Kosturit, Vodenit, Ber dhe ka përfshirë fshatrat në rrjedhën e lumit Bistrica.

Për ta shuar kryengritjen, sunduesit turq kanë dërguar ushtri të fuqishme. Pas rrethimit njëmuor, Negushi është pushtuar. Gjatë kësaj, rreth 2000 njerëz janë vrarë, qyteti u shkatërrua, ndërsa pjesa më e madhe e popullatës i zunë robër. Pas qytetit Negush, kryengritjet kanë vazhduar në rrethinën e tij. Kryengritësit të cilët mbijetuan, në vjeshtë u larguan për Greqi, për t'iu bashkangjitur kryengritësve grekë. Për shuarjen e shpejtë të kryengritjes ka kontribuar afërsia e Selanikut, ku ishin përqendruar ushtri të fuqishme turke.

Cilat kanë qenë shkaqet për kryengritjen e Negushit?



Vendbanimet e përfshira nga përgatitjet për kryengritjen e Negushit

TEMA 4.
LUFTA NACIONALÇLIRIMTARE E
POPULLIT MAQEDONAS



DERI NË LUFTRËRAT BALLKANIKE

PARAQITJA E SHKOLLAVE POPULLORE MAQEDONASE

Gjatë sundimit shumë shekullor osman në Maqedoni, arsimi, shkolla dhe kultura janë zhvilluar kryesisht, nëpër kishat dhe manastiret. Ato kanë qenë qendrat e vetme kulturore - arsimore të popullit maqedonas dhe pararojë të frymës dhe vetëdijes së popullit maqedonas. Në to janë ruajtur dhe kultivuar tradita e jetës popullore, e cila është trashëguar brez pas brezi. Si rezultat i zhvillimit ekonomik të qyteteve maqedonase në fillim të shek.

XIX, qytetaria e forcuar maqedonase ka ndjerë nevojën e përhapjes së arsimit, përmirësimit e punës së shkollave të deriatëhershme në celula dhe hapjen e shkollave të reja fetare. Në fillim qytetarët më të pasur maqedonas i kanë dërguar fëmijët e tyre në shkollat greke, ku arsimi është zhvilluar në gjuhën greke. Por në vitet e tridhjeta të shek. XIX, filluan të hapen shkolla

komunale, në të cilat mësimi është zhvilluar

në gjuhën popullore maqedonase. Shkolla të këtilla janë hapur në Shkup, Shtip, Prilep, Tetovë, Kumanovë, Nevrokop etj. Ndër mësuesit më të shquar të asaj kohe ka qenë Jordan Haxhi Konstantinov - Xhinot.



Dimitar Milladinov



Partenija Zografski

Pse janë hapur shkollat në gjuhën popullore maqedonase?